




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org



Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturive

Komuna e Klinës

2017 - 2021

Shkurt 2017

Fjala e kryetarit



Qytetarë të komunës së Klinës, ne si administratë komunale jemi zotuar që të menaxhojmë mbeturinat në mënyrë sa më të qendrueshme. Hartimi i Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave e konfirmon zotimin tonë në këtë fushë. Nëpërmes këtij plani komuna e Klinës do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të investuar në mënyrë të planifikuar në sistemin e menaxhimit në komunë. Planifikimi i tillë do të përmirësojë gjendjen e menaxhimit të mbeturinave, dhe përfundimisht do të ndikojë edhe në gjendjen mjedisore në komunën tonë. Duke e rregulluar sistemin e menaxhimit të mbeturinave në komunë ne gjithashtu synojmë që të krijojmë kushte edhe për zhvillim ekonomik lokal, nëpërmes veprimeve për ndarje dhe reciklim.

Në fund, ne si administratë komunale jemi duke bërë përpjekjet për të krijuar një ambient sa më të pastër për qytetarët tanë, mirëpo kjo mund të arrihet vetëm në bashkepunim të plotë të të gjithë akterëve në komunë.

Singerisht,
Sokol Bashota

1	Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave	5
1.1	Qëllimi i planit	5
1.2	Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë	5
1.3	Korniza ligjore	6
1.4	Rolet dhe përgjegjësitë në nivel qendror dhe lokal	6
2	Konteksti lokal	8
2.1	Përshkrim i situatës në Komunë	8
2.2	Të dhëna mbi venbanimet në Komunë	9
2.3	Të dhëna të veçanta mbi Komunën	11
3	Menaxhimi i mbeturinave	12
3.1	Detyrat dhe përgjegjësitë e komunës	12
3.2	Detyrat dhe përgjegjësitë e KRM "Ambienti"	12
3.3	Shkalla e mbulueshmërisë së territorit me shërbime	13
3.4	Sistemi ekzistues i menaxhimit të mbeturinave	16
3.5	Sasia dhe lloji i mbeturinave	18
3.6	Perbërja e mbeturinave	19
3.7	Deponimi i mbeturinave	21
3.8	Trajtimi dhe riciklimi	22
3.9	Mbeturinat shtazore dhe medicinale	22
3.10	Deponitë ilegale – mbeturinat ndërtimore	23
4	Performanca e ofruesit të shërbimeve	24
4.1	Mbledhja dhe transporti i mbeturinave	24
4.2	Performanca e të hyrave dhe arkëtimit	25
4.3	Të dhëna të përgjithshme financiare mbi menaxhimin e mbeturinave	26
4.4	Kostot Totale të Shërbimit	29
4.5	SWOT analiza	34
5	Plani operacional	36
5.1	Vizioni	36
5.2	Objektivat e nivelit qendror	36
5.3	Objektivat e PKMM Klinë	37
6	Plani Financiar	59
6.1	Projeksioni i kostove të shërbimit	59
6.2	Projeksionet e të hyrave dhe arkëtimit	72
6.3	Mbulimi i kostos dhe financimi i programit të MM	73
8.	Plani i veprimit	77
9.	Monitorimi dhe vlerësimi	89

Lista e shkurtesave

GIZ	Die Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
KRM	Kompania Regjionale për Grumbullimin e Mbeturinave
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
PKMM	Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave
PRKMM	Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
SMS	Sustainable Municipal Services
SRKMM	Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
ZRRUM	Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik

1 Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

1.1 Qëllimi i planit

PKMM-ja paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Komuna e Klines është e përcaktuar që të përmirësoj gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe në këtë drejtim ka parashtruar qëllimin dhe objektivat specifike që janë pjesë integrale e këtij plani.

Qëllimi i PKMM është ofrimi i kornizës konceptuale për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për periudhën pesëvjeqare për territorin a administruar nga komuna në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kornizën planifikuese strategjike. PKMM është i hartuar në mënyrën që merr për bazë parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave sa vijon

- Parimi i menaxhimit të mbeturinave sipas prioritetit, d.m.th. dhënja prioriteteve të reduktimit, minizimit dhe procesimit të mbeturinave karshi deponimit të tyre
- Përgjegjësia e prodhuesit, d.m.th. Prodhuesit e mbeturinave janë të detyruar të bartin koston e të gjitha masave parandaluese për ndotjen e mjedisit, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave.
- Parimi ndotësi paguan, d.m.th. Ata që ndotin mjedisin duhet të bartin koston totale të menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë për koston e masat parandaluese dhe eliminimin e dëmit të shkaktuar nga aktivitetet e tyre.
- E drejta e qasjes në informacione, d.m.th. qytetarët duhen të jenë të informuar dhe të kenë qasje tek informacioni relevante
- Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje, përfshi hartimin dhe miratimin e PKMM
- Qasja hap pas hapi dmth përmirësimi gradual i gjendjes së menaxhimit të mbeturinave përmes marrjes së veprimeve në etapa

PKMM do të shërbej si kornizë planifikuese dhe e veprimit për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e buxheteve, përpilimin e planeve investuese, tëhekjen e asistencës së jashtme e kështu me radhë.

1.2 Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë

Gjendja e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë aktualisht është mjaft e palakmueshme dhe kjo konstatohet në dokumente të ndryshme zyrtare dhe jozyrtare si Raporti i gjendjes së mjedisit dhe Raporti i gjendjes së Mbeturinave. Një pjesë e konsiderueshme e popullatës nuk është e mbuluar me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, si dhe mbeturinat e gjeneruara nga kjo pjesë e popullatës përfundojnë në deponi ilegale, në brigje të lumenjëve dhe vende tjera të papërshtatshme. Edhe për pjesën e tjetër të popullatës të mbuluar me shërbim gjendja e menaxhimit të mbeturinave nuk është e kënaqshme. Probleme ka me cilësinë e shërbimeve, infrastrukturën e vjetëruar të kontejnerëve dhe kamionëve dhe me menaxhimin e deponive në nivel regional dhe komunal të cilat janë shëndrruar në burim të ndotjes për mjedisin përreth.

Problemet janë të shumta edhe me menaxhimin e llojeve tjera të mbeturinave. Në mungesë të infrastrukturës adekuate mbeturina e mbetjeve shtazore përfundojnë në deponitë sanitare apo në vende tjera joadekuate. Aktivitetet e shtuara ndërtimore shpeshherë të pakontrolluara kanë rezultuar në gjenerim të sasive të mëdha të mbeturinave e cila në mungesë të deponive inerte është ndër shkaktarët kryesor për krijimin e deponive ilegale.

Komplekset industrial të kohës së paraluftës si Shkritoja Trepça, Kosova A, Industria e Tekstilit Emin Duraku Gjakovë, IMK Ferizaj, dhe të ngajshme në mungesë të impijanteve trajtuese dhe teknologjive joadekuate të cilat nuk kanë shfrytëzuar si duhet lëndën e parë kanë rezultuar në gjenerim të madh të hotspoteve me mbeturinave hazarde të cilat paraqesin rrezik potencial për

ambientin ku gjenden. Për sanimin e tyre nevojiten studime të specializuara si dhe mjete financiare dhe pajisje teknologjike të kushtueshme.

Donacionet dhe trgëtimi i pakontrolluar i barnave dhe materialeve medicinale ka sjell deri te gjenerimi i sasive të konsiderueshme të barnave, dhe llojeve tjera të materialeve shpenzuese të cilave ju ka kaluar afati dhe janë shndërruar në mbeturina të rrezikshme. Kësaj sasive i shtohet edhe material medicinal për asgjësim dhe barna me afat të skaduar nga QKMF dhe të gjitha spitaleve rajonale. Asgjësimi i këtij materiali të rrezikshëm është i kushtueshëm dhe kërkon angazhimin e operatorëve të specializuar.

Mungesa e sistemit funksional për menaxhimin e mbeturinave, ka pasur dhe vazhdon të ketë efekte negative në mjedis; ujë, ajër, tokë dhe shëndetin e njeriu. Kjo imponon që në periudhën aktuale faktorët relevant të organizohen dhe ti japin mbështetjen e duhur menaxhimit të përmirësuar të mbeturinave në nivel të Kosovës.

1.3 Korniza ligjore

Akti themelor për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është Ligji 2011-04 L 060 për Mbeturinat i cili rregullon aspektet specifike të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe llojeve tjera të mbeturinave. Ligji në fjalë ndërmjet tjerash ofron parimet bazë mbi menaxhimin e mbeturinave përfshi klasifikimin e mbeturinave si dhe rolet e përgjegjësive të aktorëve kyq në menaxhimin e tyre, aspektet e operimit si licencimi e kështu me radhë.

Në mënyrë specifike Ligji i Mbeturinave përmes Nenit 15 i përcakton kompetencat e komunave sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Komunitet sipas këtij Neni janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planeve Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përzgjedhjes së operatorëve të licencuar si dhe përcaktimit të tarifave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve. Ligji i mbeturinave është hartuar në masë të konsiderueshme me direktivat përkatëse të KE që e rregullojnë lëmin e menaxhimit të mbeturinave urbane dhe rrjedhave tjera të mbeturinave.

Korniza Ligjore përmban edhe një numër të konsideruar të ligjeve tjera sektoriale të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Këto Ligje përfshijnë: Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.

Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë të komunave përfshi edhe aspektet e menaxhimit operativ dhe financiar të shërbimit dhe buxhetimit.

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ndërmjet tjerash rregullon aspektet relevante të pronësisë së ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen korporative, transparencën financiare, dhe formimin e ndërmarrjeve komunale.

Dokumentat tjera planifikuese-ligjore në lëmin e menaxhimit të mbeturinave janë edhe: Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2024, Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2017, dhe Master Plani i Menaxhimit të Mbeturinave 2015-2024.

1.4 Rolet dhe përgjegjësitë në nivel qendror dhe lokal

Rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq sa i përket menaxhimit të mbeturinave janë të sanksionuara me Ligjin mbi Mbeturinat dhe aktet tjera relevante ligjore dhe nënligjore. Autoritet kryesore të menaxhimit të mbeturinave janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor dhe Komunitet e Kosovës. Sipas Ligjit të Mbeturinave Ministria administron me mbeturinat e rrezikshme, mbeturinat toksike, mbeturinat likuide, industriale dhe të ngjashme. Komunitet nga

ana tjetër menaxhojnë me mbeturinat komunale, mbeturinat inerte dhe nga demolimet, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat tjera jo të rrezikshme.

Neni 14 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e MMPH dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i). Hartimin e ligjeve, politikave strategjisë për menaxhimin e mbeturinave; (ii) zbatimin e strategjisë dhe masterplanit; (iii) dhënjen e licencave për operatorët; (iv) krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për menaxhimin e mbeturinave dhe kompetenca tjera.

Neni 15 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e Komunave dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i) krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave; (ii) hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave; (iii) përzgjedhjen e personave të licencuar për menaxhimin e mbeturinave; dhe (iv) caktimin e tarifave të mbeturinave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve.

Autoritet tjera për menaxhimin e mbeturinave janë:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike në Nivel Qëndror përfshi Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës; caktimi i tarifave për deponimin e mbeturinave
- Ministria e Shëndetësisë: Menaxhimin e Mbeturinave dhe Produkteve Medicinale
- Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural: - menaxhimi i mbeturinave veterinare.
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Ministria e Punëve të Brendshme: - bënë koordinimin në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe sipas nevojës cakton anëtarët pjesëmarrës në komisionin për vlerësimin e dëmeve eventuale nga mbeturinat.
- Dogana e Republikës së Kosovës, kryen kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit, eksportit dhe kalimit transit të mbeturinave
- Policia e Republikës së Kosovës bashkëpunon me agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e veprimeve të ndaluara dhe keqpërdorimit të mbeturinave.

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhimin e mbeturinave janë paraqitur si më poshtë:

- Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP) është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale, monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave tjera komunale.
- DSHP është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave
- Drejtoria e Financave është përgjegjëse për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, e cila ndër të tjera është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit hapësor dhe urbanistik të Komunës, ndihmon në përgatitjen e rregullores lokale për kontroll të mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të Komunës, po ashtu siguron mbështetje në zhvillimin e projekteve në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit.

- Drejtoria për Punë Inspektuese e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bujqësisë dhe Pylltarisë.
- Komisioni komunal i aksionarëve iKRM "Ambienti" ushtron mbikëqyrje të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të KRM "Ambijenti". Komisioni ka autoritet edhe të shkarkoj Bordin e Drejtorëve në rast të përfundimit të punës së mirë.

2 Konteksti lokal

2.1 Përshkrim i situatës në Komunë


Komuna e Klinës shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës, përkatësisht në pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit. Komuna e Klinës kufizohet me shtatë komuna - në veri kufizohet me Istogun, në lindje me Skenderaj dhe Drenasin, në jug me Malishevën, Rahovecin dhe Gjakovën, ndërsa në perëndim me Pejën. Komuna e Klinës përfshinë një sipërfaqe prej 308.8 kilometra katrorë dhe administrohet nga 9 zyra vendore dhe ka 54 vendbanime.

Harta Nr. 1: Pozita gjeografike e komunës së Klinës në Kosovë



Qyteti i Klinës ka pozitë qendrore në kontekst të komunës dhe paraqet një të rëndësishme të qarkullimit. Përveç Klinës, si qendër komunale, në kuadër të komunës përfshihen edhe këto vendbanime: Berkovë, Binxhë, Bokshiq, Budisalc, Çabiq, Caravik, Deiq, Dobërdol, Dollc, Dollovë, Dranashiq, Drenoc, Dresnik, Dugajevë, Dush, Dush i Vogël, Gjurgjevik i Madh, Gjurgjevik i Vogël, Gllarevë, Grabanicë, Grabc, Gremnik, Jagodë, Jashanicë, Jelloc, Kërrnicë, Klinafc, Këpuz, Krushevë e Madhe, Krushevë e Vogël, Leskoc, Nagllavë, Përçevë, Pjetërq i

Harta Nr. 2: Vendbanimet në komunën e Klinës (Burimi: Enti i Statistikës së Kosovës)



Edhe pse territori i Klinës dhe i tërë Dukagjini përbën një pjesë të mbyllur më vete dhe tërëthuar me male, prapë se prapë kushtet e volitshme natyrore mundësojnë të ketë lidhje të miratë qarkullimit. Rol të rëndësishëm në pozitën e Klinës luan edhe përshkruarja e lumit Drini i Bardhë, i cili lidhë Kosovën me Republikën e Shqipërisë ndërsa Llapusha e lidhë këtë territor me Prishtinën dhe më gjerë. Pozita natyrore dhe konfiguracioni mundësojnë që Klina të ketë lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore me rajonin e gjerë. Nëpër Klinë kalon rruga magjistrale Prishtinë - Pejë (dukë përfshirë edhe kryqëzimin për Gjakovë), rruga regjionale Klinë – Skenderaj – Mitrovicë dhe rruga regjionale Klinë – Istog – Pejë. Nëpër komunën e Klinës kalojnë edhe vijat hekurudhore Fushë Kosovë – Klinë - Pejë dhe Fushë Kosovë - Klinë – Prizren. Lidhjet rrugore dhe hekurudhore që kalojnë nëpër territorin e Klinës, përveç që e lidhin Klinën me qendrat tjera në Kosovë, mundësojnë edhe lidhje të mëtejme me qendrat në rajon, duke qenë një potencial i rëndësishëm

Komuna e Klinës ka 54 vendbanime me një numër total të popullsisë prej 38,496 banorë, dhe më një numër total të amvisërive prej 5,843. Sipas të dhënave nga KRM “Amienti”, në Klinë janë të regjistruar edhe 11,200 banorë që jetojnë jashtë vendit. Vlerësimi i rritjes së popullësisë është bërë bazuar në të dhënat e BB, dhe raportimet makroekonomike, që rezultojnë me një rritje të popullësisë 0.8% në vit, ku merret parasysh rritja e natyrshme por edhe migrimi dhe emigrimi.

Tabela Nr. 1: Numri i popullsisë dhe amvisërive në komunën e Klinës¹

Nr.	Vendbanimet	Te dhena nga ASK regjistrimi 2011		Vlersimi 2015		Vlersimi 2016		Vlersimi 2017		Vlersimi 2018		Vlersimi 2019		Vlersimi 2020		Vlersimi
		nr.banoreve	amviserite	nr.banoreve	amviserite	nr.banoreve	amviserite	nr.banoreve	amviserite	nr.banoreve	amviserite	nr.banoreve	amviserite	nr.banoreve	amviserite	nr.banoreve
1	Bërkovë	246	49	254	51	256	43	258	51	260	52	262	52	264	53	266
2	Binxhë	117	18	121	20	122	21	123	21	124	21	125	21	126	21	127
3	Bokshiq	433	54	447	76	451	76	454	77	458	77	462	78	465	79	469
4	Budisalc	398	64	411	70	414	70	417	71	421	71	424	72	428	72	431
5	Caravik	1,241	175	1,281	217	1,291	219	1,302	220	1,312	222	1,323	224	1,333	226	1,344
6	Çabiq	862	120	890	151	897	152	904	153	911	154	919	155	926	157	933
7	Deiq	376	61	388	66	391	66	394	67	398	67	401	68	404	68	407
8	Dobërdol	339	54	350	59	353	60	356	60	358	61	361	61	364	62	367
9	Dolc	276	53	285	48	287	49	290	49	292	49	294	50	297	50	299
10	Dollovë	444	70	458	78	462	78	466	79	469	79	473	80	477	81	481
11	Dranashiq	21	4	22	4	22	4	22	4	22	4	22	4	23	4	23
12	Drenoc	440	60	454	77	458	77	462	78	465	79	469	79	473	80	476
13	Drshnik	1,770	304	1,827	309	1,842	312	1,857	314	1,872	317	1,887	319	1,902	322	1,917
14	Dugajevë	399	67	412	70	415	70	419	71	422	71	425	72	429	73	432
15	Dush	241	31	249	42	251	42	253	43	255	43	257	43	259	44	261
16	Dushi Vogël	196	33	202	34	204	35	206	35	207	35	209	35	211	36	212
17	Gllarevë	1,784	218	1,842	312	1,857	314	1,871	317	1,886	319	1,901	322	1,917	324	1,932
18	Grabanicë	728	114	752	127	758	128	764	129	770	130	776	131	782	132	788
19	Grabc	206	28	213	36	214	36	216	37	218	37	220	37	221	37	223
20	Gremnik	1,131	151	1,168	156	1,177	157	1,186	158	1,196	160	1,205	161	1,215	162	1,225
21	Gjurgjevik i Madh	449	51	464	78	467	79	471	80	475	80	479	81	482	82	486
22	Gjurgjevik i Vogël	745	119	769	130	775	131	781	132	788	133	794	134	800	135	807
23	Jagodë	197	34	203	34	205	35	207	35	208	35	210	36	212	36	213
24	Jashanicë	1,784	267	1,842	312	1,857	314	1,871	317	1,886	319	1,901	322	1,917	324	1,932
25	Jelloc	27	5	28	5	28	5	28	5	29	5	29	5	29	5	29
26	Këmicë	794	110	820	139	826	140	833	141	840	142	846	143	853	144	860
27	Klinafc	480	88	496	84	500	85	504	85	508	86	512	87	516	87	520
28	Klinë	5,542	1,010	5,721	1,046	5,767	1,054	5,813	1,063	5,860	1,071	5,907	1,080	5,954	1,088	6,002
29	Kpuz	622	87	642	109	647	110	652	110	658	111	663	112	668	113	674
30	Krushevë e Madh	585	101	604	102	609	103	614	104	619	105	624	106	628	106	634
31	Krushevë e Vogël	323	56	333	56	336	57	339	57	342	58	344	58	347	59	350
32	Leskoc	239	32	247	42	249	42	251	42	253	43	255	43	257	43	259
33	Nagllavë	67	13	69	12	70	12	70	12	71	12	71	12	72	12	73
34	Përrevë	1,005	117	1,038	176	1,046	177	1,054	178	1,063	180	1,071	181	1,080	183	1,088
35	Pjetërq i Epërm	563	97	581	98	586	99	591	100	595	101	600	102	605	102	610
36	Pjetërq i Poshtëm	160	23	165	28	167	28	168	28	169	29	171	29	172	29	173
37	Pograxhë	366	52	378	64	381	64	384	65	387	65	390	66	393	67	396
38	Qeskovë	373	47	385	65	388	66	391	66	394	67	398	67	401	68	404
39	Qupevë	579	89	598	101	603	102	607	103	612	104	617	104	622	105	627
40	Raduloc	353	61	364	62	367	62	370	63	373	63	376	64	379	64	382
41	Ranoc	353	59	364	62	367	62	370	63	373	63	376	64	379	64	382
42	Rcsnik	399	55	412	70	415	70	419	71	422	71	425	72	429	73	432
43	Rixhevë	870	112	898	152	905	153	913	154	920	156	927	157	935	158	942
44	Rudicë	446	75	460	78	464	79	468	79	472	80	475	80	479	81	483
45	Sferkë	2,448	296	2,527	428	2,547	431	2,568	434	2,588	438	2,609	441	2,630	445	2,651
46	Siqevë	1,338	205	1,381	234	1,392	236	1,404	237	1,415	239	1,426	241	1,437	243	1,449
47	Stupë	179	32	185	31	186	32	188	32	189	32	191	32	192	33	194
48	Shtupel	771	113	796	135	802	136	809	137	815	138	822	139	828	140	835
49	Ujmir	544	86	562	95	566	96	571	97	575	97	580	98	584	99	589
50	Videjë	663	105	684	116	690	117	695	118	701	119	707	120	712	121	718
51	Volljak	929	118	959	162	967	164	974	165	982	166	990	168	998	169	1,006
52	Zabërgjë	728	102	752	127	758	128	764	129	770	130	776	131	782	132	788
53	Zajm	1,267	184	1,308	221	1,318	223	1,329	225	1,340	227	1,350	228	1,361	230	1,372
54	Zllakuqan	660	114	681	115	687	116	692	117	698	118	703	119	709	120	715
Totali		38,496	5,843	39,743	6,769	40,061	6,815	40,381	6,878	40,704	6,933	41,030	6,988	41,358	7,044	41,689

¹ Llogaritja e rritjes së popullsisë është bërë sipas të dhënave për llogaritje makroekonomike të Bankës Botrore

2.3 Të dhëna të veçanta mbi Komunën

2.3.1 Arsimi

Procesi edukativo-arsimor në komunën e Klinës zhvillohet në tre nivele: arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm. Në kuadër të këtij sistemi funksionojnë 17 institucione të shkollimit fillor 2 shkolla të mesme dhe një çerdhe e fëmijëve.

2.3.2 Shëndetësia

Në komunën e Klinës shërbimi publik primar shëndetësor ofrohet në:

- Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Klinë,
- Qendrat e mjekësisë familjare në fshatrat Zllakuqan, Ujmirë dhe Sverkë, dhe
- 11 ambulanca (punte shëndetësore) në fshatrat Budisalc, Jagodë, Drenoc, Grabanicë, Volljakë, Gllarevë, Cerovikë, Jashanicë, Jashanicë e Epërme dhe Shtupel.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ‘NënaTerezë’ paraqet institucionin kryesor shëndetësor në komunë. Në kuadër të këtij institucioni, përpos kujdesit primar shëndetësor, ofrohen edhe shërbimi i ndihmës së shpejtë, praksës së përgjithshme, shërbimi internist, shërbimi i pediatriisë dhe i gjinekologjisë, shërbimi ORL, shërbimi i dispanzerit antituberkular, shërbimi neuropsikiatrik, shërbimi i rëntgenit, shërbimi i vaksinimit, shërbimi i laboratorit, shërbimi i paltronazhit, shërbimi stomatologjik. Përpos shërbimit publik në shëndetësi, në Klinë është prezent edhe praksa private si me poliklinika, ambulanca dhe barnatore. Shërbimi shëndetësor dytësor më i afërt ofrohet në Spitalin Regional në Pejë.

2.3.3 Administrata publike dhe lokale

Shërbimet administrative kryesore në nivel të komunës janë të përqendruara në Klinë, ku përfshihen shërbimet e Kuvendit Komunal me zyret përkatëse, Qendra për Punë Sociale (në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale), Qendra për Rergjistrim (në kuadër të Ministrisë për Punë të Brendshme), Post-Telekomi, si dhe filialat e disa prej bankave komerciale. Përqendrimi i këtyre shërbimeve në qytetin e Klinës, si dhe i shërbimeve tjera - shkollimi dhe shëndetësia me qasje të lehtë, infrastruktura etj. janë faktorë që kanë ndikuar në tendencat për largimin nga zonat rurale. Në zonat rurale, shërbimet e vetme administrative ofrohen përmes 13 zyrave të bashkësive lokale.

2.3.4 Bizneset, burimet natyrore dhe turizmi

Si resurs i veçantë është edhe parku natyror ‘Mirusha’ i cili me vetitë e rralla estetike, paraqet mundësi për zhvillimin e turizmit me ndikim edhe në qytetin e Klinës. Ujëvarat e Mirushës paraqesin një resurs shumë të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në komunën e Klinës. Këto ujëvare të cilat shtrihen përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha, shquhen me vlera të çmueshme natyrore fiziko-gjeografike dhe të florës dhe faunës. Statuti aktual i kësaj zone të mbrojtur është park natyror. Vlerat e tilla mundësojnë jo vetëm turizmin në nivelin lokal, por edhe më gjerë, atë ndërkombëtar. Identifikimi i zonave të zhvillimit dhe hartimi i planit hapësinor të parkut natyror Mirusha, do të mundësonte hapjen e rrugës për investime në turizëm, e rëndësishme posaçërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të Klinës të cilat merren me turizëm dhe hotelieri. Kjo do të mundësonte edhe krijimin e të ardhurave të rëndësishme për buxhetin komunal. Ndërmarrjet e mesme dhe të vogla, 2,100 të regjistruara janë të përqendruara kryesisht në qytetin e Klinës, ndërsa në pikëpamje të hapësirës, nuk kërkojnë kushte të posaçme të vendosjes. Shumica e aktiviteteve të banorëve është në veprimtaritë shërbyese – hoteliere dhe zejtare e cila në shumicën e rasteve zhvillohet në kuadër të objekteve të banimit përgjatë rrugëve kryesore. Përveç veprimtarive shërbyese, pas luftës së fundit në Klinë janë themeluar edhe ndërmarrje prodhuese për nevojat e ndërtimtarisë, të cilat kanë renome edhe në mbarë Kosovën. Klina, po ashtu ka një numër të konsideruar të fermave, deri më tani janë të regjistruar 1,570 fermer në të gjitha veprimtaritë bujqësore.

2.3.5 Resurset natyrore

Komuna e Klinës është mjaftë e pasur me resurse natyrore duke përfshirë minerale dhe jominerale që është bazë e mirë për tërheqjen e investimeve. Ka një sasi të rezervave të Linjtit, minerale të boksitit, argjilë, rërë dhe zhavor. Rezervat e linjtit dhe mineralet e boksitit nuk janë në shfrytëzim për momentin, mirëpo në një të ardhme ato si një pasuri edhe mund të shfrytëzohen.

3 Menaxhimi i mbeturinave

3.1 Detyrat dhe përgjegjësitë e komunës

Shërbimet komunale, në këtë rast shërbimet e menaxhimit të mbeturinave janë detyrë klasike e nivelit lokal – komunave. Brenda komunës, kjo përgjegjësi i është përcaktuar Drejtoratit për Shërbime Publike dhe Emergjente (DSHPE). Sipas Statutit të komunës së Klinës, detyrat dhe përgjegjësitë e DSHPE-së për menaxhim të mbeturinave janë si në vijim:

- Sigurimin dhe mirëmbajtjen parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave,
- Mbikëqyrje dhe bashkëpunon me kompanitë shërbyese komunale të higjienës dhe furnizimit me ujë,
- Kujdeset për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta,
- Në bashkëpunim me kompanitë cakton çmimet e shërbimeve komunale,
- Të hartojnë planin lokal për administrimin e mbeturinave,
- Të hartojnë raporte vjetore mbi administrimin e mbeturinave të cilat i dorëzojnë në Ministri, në tremujorin e parë të vitit vijues,
- Të marrin pjesë në lëshimin e vendimeve për ndërtimin e objekteve, për trajtimin e mbeturinave,
- Të caktojnë tarifat për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave,
- Aprovon orarin dhe kohën e propozuar për bartjen e mbeturinave,
- Shqyrton mundësinë e futjes në sistemin e bartjes së mbeturinave edhe të fshatrave,
- Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha shesheve që i përkasin Komunës.

Sipas ligjit mbi Mbeturina Komuna e Klinës është përgjegjëse vetëm për mbeturinat komunale, ndërsa për mbeturinat e rrezikshme dhe mbeturinat medicinale është përgjegjëse niveli qendror.

3.1.1 Struktura organizative e drejtoratit

DSHPE në Klinë është unik në Kosovë sepse funksionon vetëm me një staf, edhe pse sipas statutit të komunës këtij drejtorati i delegohen shumë detyra dhe përgjegjësi. Drejtori i DSHPE-së i kryen të gjitha punët në drejtorat.

Pavarësisht faktit që komuna është përgjegjëse për shërbime të menaxhimit të mbeturinave, në praktikë këtë përgjegjësi e bartë Kompania Rajonale e Mbeturinave "Ambienti" në Klinë. Kohëve të fundit vërehet një mobilizim dhe gatishmëri më e lartë e komunës - vendimmarrësve për të marrë përsipër praktikisht këtë përgjegjësi. Kjo po ndodh për shkak të punës së organizatave donatore që veprojnë në Kosovë, si dhe për shkak të presionit sado që i vogël që vije nga niveli qendror.

3.2 Detyrat dhe përgjegjësitë e KRM "Ambienti"

Njësia në Klinë vepron në kuadër të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Ambienti". KRM Ambienti vepron në komunën e Pejës, Klinës dhe Istogut. Njësia në Klinë është përgjegjëse për të ofruar shërbimet e grumbullimit, transportimit dhe depozitimit të mbeturinave komunale. Njësia në Klinë ka marrëveshje me komunën e Klinës për të ofruar këtë shërbim e cila

është nënshkruar në vitin 2006. Mënyerisht, nuk ka marrëveshje aktuale që i përckaton kushtet që duhet të përmbushen nga të dy palet e përfshira në marrëveshje.

Në komunën e Klinës nuk operojnë kompani private për grumbullim të mbeturinave në amvisëri, mirëpo ka raste kur bizneset e mëdhaja shërbehen nga kompani private, sikurse motel Nora, njëri ndër klientët më të mëdhenj, shërbehet nga kompania private .

3.3 Shkalla e mbulueshmërisë së territorit me shërbime

Territori i komunës së Klinës mbulohet me shërbime të grumbullimit të mbeturinave si në tabelën në vijim. Mbulimi me shërbime është llogaritur duke përdorë numrin e përgjithshëm të amvisërive, bizneseve dhe institucioneve dhe numri i faturave të lëshuara për të tri kategoritë. Kështu që nga 6,815 amvisëri në komunën e Klinës, 4,114 apo 60% marrin shërbime të grumbullimit të mbeturinave. Nga totali i amvisërive 700 janë me asistencë sociale të cilave KRM "Ambienti" gjithashtu ju ofron shërbime të grumbullimit të mbeturinave.


Në komunë janë aktive 447 biznese, dhe të gjitha marrin shërbime të grumbullimit të mbeturinave nga KRM Ambienti. Sa i përket institucioneve, në Klinë janë gjithsej 76 institucione dhe që të gjitha marrin shërbime të grumbullimit të mbeturinave. Të dhënat e prezentuara janë marr nga njësia e KRM Ambienti në Klinë. Për shkak se në kompani nuk kanë një sistem të strukturuar të raportimit nuk mund të sigurojmë që saktësia dhe preciziteti i të dhënave janë në nivelin e duhur.

Tabela Nr. 2: Mbulimi me shërbime

Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Të dhënat nga kompania Ambienti (viti 2016)				
			Amvisëritë			Bizneset	Institucionet
			gjithësej	të shërbyera	të shërbyera %	të shërbyera	të shërbyera
	Komuna e Klinës	40,061	6,815	4,114	60.3%	447	72
1	Bërkovë	256	43	25	58%		
2	Binxhë	122	21	0	0%		
3	Bokshiq	451	76	35	46%		
4	Budisalc	414	70	64	91%		1
5	Caravik	1,291	219	168	77%		1
6	Çabiq	897	152	89	59%		1
7	Deiq	391	66	56	85%		
8	Dobërdol	353	60	47	78%		
9	Dollc	287	49	21	43%		
10	Dollovë	462	78	55	71%		
11	Dranashiq	22	4	4	100%		
12	Drenoc	458	77	46	60%	3	1
13	Drshnik	1,842	312	43	14%		
14	Dugajevë	415	70	23	33%		
15	Dush	251	42	19	45%		
16	Dush i Vogël	204	35	28	80%		
17	Gllarevë	1,857	314	186	59%	2	1
18	Grabanicë	758	128	65	51%	1	1
19	Grabc	214	36	0	0%		
20	Gremnik	1,177	157	108	69%	5	1
21	Gjurgjevik i Madh	467	79	51	65%		1

22	Gjurgjevik i Vogël	775	131	52	40%		
23	Jagodë	205	35	34	97%		1
24	Jashanicë	1,857	314	112	36%		1
25	Jelloc	28	5	0	0%		
26	Kërnice	826	140	31	22%		
27	Klinafc	500	85	6	7%	2	
28	Klinë	5,767	1,054	1010	96%	418	53
29	Kpuz	647	110	66	60%		1
30	Krushevë e Madhe	609	103	95	92%		
31	Krushevë e Vogël	336	57	49	86%		
32	Leskoc	249	42	47	112%		
33	Nagllavë	70	12	2	17%		
34	Përqevë	1,046	177	102	58%	1	
35	Pjetërq i Epërm	586	99	43	43%		1
36	Pjetërq i Poshtëm	167	28	45	161%		
37	Pograxhë	381	64	33	52%		
38	Qeskovë	388	66	37	56%		
39	Qupevë	603	102	33	32%		
40	Raduloc	367	62	53	85%	2	
41	Ranoc	367	62	62	100%		
42	Resnik	415	70	0	0%		
43	Rixhevë	905	153	65	42%	1	
44	Rudicë	464	79	55	70%		
45	Sferkë	2,547	431	237	55%	1	1
46	Siqevë	1,392	236	63	27%		1
47	Stupë	186	32	32	100%		
48	Shtupel	802	136	60	44%		1
49	Ujmir	566	96	62	65%	1	1
50	Videjë	690	117	55	47%		
51	Volljak	967	164	99	60%	5	1
52	Zabërgjë	758	128	82	64%		
53	Zajm	1,318	223	145	65%	2	1
54	Zllakuqan	687	116	114	98%	3	1

Harta Nr. 3: Zonat aktuale të shërbimit në komunën e Klinës




Komuna e Klinës është e ndarë në 7 zona të shërbimit përfshi edhe qytetin e Klinës (shih hartën më lartë), si në vijim:

- Në zonën e qytetit të Klinës përfshihen edhe fshatrat e Drsnikut dhe Zajmit.
- Zona e parë përfshinë fshatrat Klinafç, Pograxhë, Dush, Gjurgjevik i Madh, Siqevë, Kërnice, dhe Jashanicë.
- Zona e dytë përfshinë fshatrat Përqevë, Gllarevë, Rixhevë, Doberdol, Zabergjë, Cabiq, Carravik dhe Ujmir.
- Zona e tretë përfshinë fshatrat Dolle, Gremnik, Qupevë, Volljak, Sferkë, dhe Dush i Vogël.
- Zona e katërt përfshinë fshatrat Grabanicë, Bokshiq, Dollovë, Qeskovë, Kpuz, Dugajevë, Potërq i Poshtëm dhe Potërq i Epërm.
- Zona e pestë përfshinë fshatrat Deiq, Drenoc, Videjë, Jagodë, Krushevë e Madhe, Nagllavë, Budisalc, Stupë, Rudicë.
- Zona e gjashtë përfshinë fshatrat Krushevë e Vogël, Gjurgjevik i Vogël, Raduloc, Zllakuqan, Dranashiq, Ranoc, Bërkovë, dhe Leskoc.

Vendbanimeve të cilat nuk ju ofrohet shërbim i grumbullimit të mbeturinave janë fshatrat Binxhë, Grabç, Resnik dhe Jelloc. KRM Ambienti ka në plan që gjerë në përfundim të vitit 2016 të zgjerojë shërbimet edhe në fshatrat e pa mbuluar me shërbime. Pasi që janë fshatra të izoluar dhe me numër të vogël të banorëve, shërbimi do ju ofrohet të dielave me kontejnerë 120l.

Sic vërehet nga harta e shërbimit aktual, shërbimi në komunën e Klinës kryhet në mënyrë të rregullt. Zonat janë të shpërndara duke marrë parasysh pozitën gjeografike, dhe ndërlidhjet rrugore. Në mënyrë që të kuptohet më me saktësi se si ofrohet shërbimi në komunën e Klinës, janë analizuar edhe rrugët "marshutat" e cdo kamioni për cdo ditë të shërbimit duke filluar nga e Hëna deri te Shtunën.

Harta Nr. 4: Rrugët "marshutat" e kamionëve për 6 ditë shërbimi nga e Hëna deri të Shtunën



Nga analiza e rrugëtimit të kamionëve e vërejmë që komuna e Klinës është i ndarë në 7 zona të shërbimit. Qendra e qytetit shërbehët cdo ditë, ndërsa pjesët tjera të qytetit shërbehën një herë në javë. Fshatrat marrin shërbim një herë në javë.

Shërbimi ofrohet nga 3 kamion të cilët ofrojnë shërbime në ditë të caktuara të javës. Duke marrë parasysh që komuna është e ndarë në 7 zona të shërbimit të cilat shërbehën nga tre kamion, përgjegjësitë e shërbimit për kamion janë të përziera. Kamionet punojnë 8 orë në ditë duke qenë mjaftë efektiv në grumbullim dhe transportim të mbeturive. Mangësi e sistemit është se të gjithë kamionët zbrazen e mbeturinave e bejnë në deponinë regjionale në Sferkë, Pejë. Kjo do të thotë që humbet shumë kohë për të zbrazur mbeturinat në deponinë regjionale në Sferkë, Pejë, duke llogaritur edhe amortizimin e kamioneve të cilët janë vecse të amortizuar.

Për shkak të numrit të madh të zonave të shërbimit dhe numrit të vogël të kamioneve sistemi si tillë funksionon si duhet deri në një masë.

3.4 Sistemi ekzistues i menaxhimit të mbeturinave

Grumbullimi i mbeturinave në komunën e Klinës bëhet derë më derë dhe nëpërmes kontenjereve të përbashkët. Shërbimi derë më derë kryhet nëpërmes kontenjereve 120 lit dhe

qeseve të plastikës. Ndërsa shërbimi më kontenjerë të përbashkët kryhet nëpërmes kontenjerëve 7m³ dhe 1.1m³. Bizneseve ju ofrohet shërbimi derë me derë.

Sistemi i grumbullimit të mbeturinave në komunë është si në vijim: 18 vendbanime shërbehen me qese të plastikës, 6 vendbanime më kontejnera 1.1m³, dhe 27 vendbanime me kontejnera 120 lit (shih tabelën 3).

3.4.1 Frekuenca

KRM "Ambienti" bënë grumbullimin e mbeturinave më këtë frekuencë të shërbimeve: në qytet shërbimi derë më derë ofrohet një herë në javë ndërsa në qendër çdo ditë edhe më shpesh sipas nevojës, ndërsa në sezonin e verës kur sasia e mbeturinave rritet për shkak të arrdhjes së qytetarëve nga diaspora shërbimi ofrohet edhe dy herë në javë, ndërsa nga kontejnerët 1.1 m³ grumbullohet gjashtë ditë të javës përpos të dielave, bizneset dhe institucionet me kontrata të veçanta me rast të mbushjes së kontejnerëve. Ndërsa në fshatra shërbimi bëhet derë më derë një herë në javë.


Tabela Nr. 3: Sistemi ekzistues i grumbullimit të mbeturinave për vendbanim

Nr.	Vendbanimi	Mënyra e shërbimit	Nr.	Vendbanimi	Mënyra e shërbimit
1	Bërkovë	120 lit.	28	Klinë	1.1m ³ dhe Qese
2	Binxhë		29	Kpuz	120 lit.
3	Bokshiq	120 lit.	30	Krushevë e Madhe	120 lit.
4	Budisalc	120 lit.	31	Krushevë e Vogël	120 lit.
5	Caravik	120 lit.	32	Leskoc	120 lit.
6	Çabiq	Qese	33	Nagllavë	Qese
7	Deiq	Qese	34	Përgevë	Qese
8	Dobërdol	Qese	35	Pjetërq i Epërm	1.1m ³
9	Dollec	120 lit.	36	Pjetërq i Poshtëm	1.1m ³
10	Dollovë	120 lit.	37	Pograxhë	Qese
11	Dranashiq	Qese	38	Qeskovë	120 lit.
12	Drenoc	120 lit.	39	Qupevë	Qese
13	Drshnik	120 lit.	40	Raduloc	Qese
14	Dugajevë	1.1m ³	41	Ranoc	120 lit.
15	Dush	Qese	42	Resnik	
16	Dush i Vogël	120 lit.	43	Rixhevë	120 lit.
17	Gllarevë	120 lit.	44	Rudicë	Qese
18	Grabanicë	1.1m ³	45	Sferkë	120 lit.
19	Graboc		46	Siqevë	120 lit.
20	Gremnik	120 lit.	47	Stupë	Qese
21	Gjurgjevik i Madh	120 lit.	48	Shtupel	Qese
22	Gjurgjevik i Vogël	120 lit.	49	Ujmir	120 lit.
23	Jagodë	Qese	50	Videjë	120 lit.
24	Jashanicë	Qese	51	Volljak	120 lit.
25	Jelloc		52	Zabërgjë	120 lit.
26	Kërnice	Qese	53	Zajm	1.1m ³
27	Klinafc	Qese	54	Zllakuqan	120 lit.

KRM "Ambienti", njësi në Klinë posedon 180 kontenjer metalik 1.1m³, 60 prej të cilëve janë të vendosur në qytet dhe 120 janë të vendosur nëpër 4 fshatra. Në 27 fshatra, amvisëritë janë pajisur me 2,000 copë kontenjera 120 lit, ndërsa 15 fshatra shërbehën me qese të plastikës.

Kontenjerët 1.1m³ janë në gjendje jo të mirë për shkak të amortizimit të tyre dhe investimeve të mangta, ndërsa kontenjeret 120 lit janë në gjendje të mirë sepse janë relativisht të rinj.

Figura Nr. 1 Gjendja e mbeturinave në komunën e Klinës



3.5 Sasia dhe lloji i mbeturinave

3.5.1 Sasia ekzistuese e mbeturinave

Sipas raportit për Mbeturina dhe Kimikate të AMMK-së, sasia e mbeturinave të gjeneruara për kokë banori në Kosovë është si në vijim:

- për vitin 2008 është 167 kg, apo 0.5 kg në ditë;
- për vitin 2009 është 193 kg, apo 0.5 kg në ditë;
- për vitin 2010 është 297 kg, apo 0.8 kg në ditë;
- për vitin 2011 është 335 kg, apo 0.9 kg në ditë; dhe
- në vitin 2012 është 334 kg, apo 0.9 kg në ditë.

Këto të dhëna tregojnë për një rritje të ndjeshme të sasisë së mbeturinave. Nga viti 2008 në 2009 kemi rritje për 15%; nga viti 2009 në 2010 kemi rritje për 50%; nga viti 2010 në 2011 kemi rritje për 12%; ndërsa nga viti 2011 në 2012 nuk kemi ndonjë ngritje. Trendi i rritjes së gjenerimit të mbeturinave ndryshon nga viti në vit, kjo ndodh sigurisht për shkak të rritjes së numrit të banorëve dhe standardit të jetës, dhe njëkohësisht për shkak të futjes graduale në sistem të shërbimit për grumbullim të mbeturinave.

Duke marrë parasysh që grumbullimi i mbeturinave në komunën e Klinës bëhet në mënyrë të përbashkët për amvisëri, biznese dhe institucione, nuk ekzistojnë të dhëna të vecanta për çdo kategori për sasi të mbeturinave. Sasia mesatare e mbeturinave të grumbulluara dhe deponuara në deponinë e Pejës për javë është 150 t. Nga ky numër mund të thëmi që në komunën e Klinës grumbullohen dhe deponohen 7,800 t mbeturinë në vit.

Tabela Nr. 4: Gjenerimi i mbeturinave në komunë të Klinës

Numri i klientëve të sherbyera	Numri i banorëve të shërbyer	Sasia e mbeturinave: amvisëri, biznese dhe institucione		Sasia mesatare e gjenerimit të mbeturinave për kokë banori	
		javë	Vit	vit	ditë
4,633	27,101	150 t	7,800 t	287 kg	0.78 kg

Sipas këtyrë të dhënave sasia e mbeturinave të gjeneruara për kokë banori për vitin 2015 është 287 kg, ndërsa për ditë është 0.78 kg. Nga këto rezultate vërejmë që komuna e Klinës dallon ndjeshëm nga niveli qendror sa i përket shkallës së gjenerimit të mbeturinave. Klina gjeneron 13% më pak mbeturina për kokë banori në vit për dallim nga të dhënat e gjenerimit të mbeturinave për tërë Kosovën.

3.5.2 Sasia e parashikuar e rritjes së mbeturinave 2016– 2021

Parashikimet për rritjen e popullësisë në komunën e Klinës janë bazuar në të dhënat e Bankës Botrore, dhe raportimet makroekonomike, që rezultojnë me një rritje të popullësisë me indeks 0.8% në vit, ku merret parasysh rritja e natyrshme por edhe migrimi dhe emigrimi. Prandaj sipas kësaj llogaritje, popullësia e Klinës ka një trend rritje sikurse që është prezentuar në tabelën më poshtë. Për planifikimet e këtij plani ne do të marrim parasysh rritjen nga viti 2017 – 2021:

Tabela Nr. 5: Skenari i rritjes së popullatës

2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
39,743	40,061	40,381	40,704	41,030	41,358	41,689

Sipas këtyrë parashikimeve rezultojnë që numri i banorëve në komunën e Klinës në vitin 2021 do të rritet për 10.5%. Në vitin 2021 parashikohet që komuna e Klinës të ketë 41,689 banorë.

Sipas të dhënave nga Master Plani për Menaxhim të Mbeturinave², raportohet se konsumi i familjeve në Kosovë në pesë vitet e fundit është rritë 10%. Nga kjo e dhënë supozohet që për 5 vitet e ardhshme sasia e mbeturinave në Kosovë, respektivisht në komunën e Klinës do të rritet për 10%, apo përafërsisht 2% për vit.

Nga tabela më poshtë vërejmë që parashikimet për rritje të sasisë së mbeturinave për vitin 2016 do të jenë 293kg/vit apo 0.80kg/ditë për kokë banorë, ndërsa në vitin 2021 sasia do të arrijë kuotën prej 323 kg/vit apo 0.89 kg/ditë për kokë banori.

Tabela Nr. 6: Parashikimi i rritjes së sasisë së mbeturinave 2016– 2021

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Nr i popullsisë me rritje 0.8%	39,743	40,061	40,381	40,704	41,030	41,358	41,689
Sasia e mbeturinave për kokë banori/vite, me rritje 2%	287	293	299	305	311	317	323
Sasia e mbeturinave për kokë banori/dite	0.78	0.80	0.82	0.83	0.85	0.87	0.89
Sasia e mbeturinave për 100% të popullatës në vite	11,406	11,727	12,058	12,397	12,746	13,105	13,474

3.6 Përbërja e mbeturinave

Momentalisht në Kosovë nuk kemi ndonjë të dhënë të vitit 2016 e cila e përshkruan përberjen e mbeturinave. Analiza të përbërjes së mbeturinave janë bërë nga organizata donatore që veprojnë në Kosovë, GIZ, JICA dhe Zyra e Komisionit Evropian. Këto analiza janë bërë për të gjithë Kosovën. Analiza më e fundit është punuar nga Zyra e Komisionit Evropian – Master Plani për Menaxhim të Mbeturinave. Edhe pse analiza i referohet gjithë Kosovës, rezultatet e saja janë përdorur si bazë për të përcaktuar përbërjen aktuale të mbeturinave dhe për të parashikuar përbërjen e mbeturinave në vitet në vijim në komunën e Klinës.

Grafiku Nr. 1: Përbërja aktuale e mbeturinave në Kosovë

² Master Plani për Menaxhim të Mbeturinave, Zyra e Komisionit Evropian 2014




Tabela Nr. 7: Përbërja e mbeturinave në komunën e Klinës në sasi

	Lloji i mbeturines	Përbërja në nivel Kosove	Përbërja në Komunën e Klinës t/vit 2015
1.	Organike	54.5%	4,252
2.	Kategori tjera	20.1%	1,569
3.	Metale	1.1%	87
4.	Qelq	2.3%	181
5.	Plastik	12.4%	968
6.	Leter	7.8%	609
7.	Dru	1.7%	134
	Totali	100%	7,800

Nga analiza mund të konkludojmë pas mbeturinave organike, mbeturinat e plastikës pasuar nga mbeturina e letrës/kartonit janë mbeturinat që gjenerohen në masë të madhe në Kosovë. Komuna e Klinës gjeneron 7,800 t mbeturina në vit, dhe nga përbërja e mbeturinave nga tabela Nr. 7 mund të thëmi që 15% - 20% nga sasia totale e mbeturinave të gjeneruara në vit janë sasi potenciale për reciklim. Ndërsa 40% - 45% nga sasia totale e mbeturinave të gjeneruara në vit janë sasi potenciale për kompostim.

Kështu që potenciali për kompostim, ndarje dhe reciklim të mbeturinave, dhe për ulje të sasisë së mbeturinave të cilat përfundojnë në deponi është mjaft i lartë. 60% - 65% të mbeturinave mund të kompostohen apo reciklohen.

3.6.1 Parashikimi i përbërjes së mbeturinave

Sic u cek më lartë analiza e parashikimit të përbërjes së mbeturinave (nivel Kosove) është marrë nga Master Plani për Menaxhim të Mbeturinave. Kjo analizë është bazuar në rritjen ekonomike, ndryshimin e mënyrës së jetës së qytetarëve (rritja e konsumit të ushqimit të pakeluar), dhe masat të cilat duhet të ndërmerren në të ardhmën për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e gjenerimit të mbeturinave.

Grafiku Nr. 2: Parashikimi i përbërjes së mbeturinave viti 2021




Tabela Nr. 8: Parashikimi i përbërjes së mbeturinave në sasi viti 2021


Lloji i mbeturinave	Përbërja në nivel Kosove 2015	Parashikimi i përbërjes në nivel Kosove 2016	Parashikimi i përbërjes në nivel Kosove 2021	Parashikimi i përbërjes në nivel të Komunës së Klinës 2016 t/v	Parashikimi i përbërjes në nivel të Komunës së Klinës 2021 t/v
Organike	55%	53%	52%	6,215	7,060
Kategori tjera	20%	20%	20%	2,345	2,695
Metale	1%	1%	1%	141	168
Qelq	2%	3%	3%	293	344
Plastik/PET	12%	13%	14%	1,548	1,819
Leter/karton	8%	8%	9%	985	1,152
Dru	2%	2%	2%	199	236
totali	100%	100%	100%	11,727	13,474

Nga parashikimi i përbërjes së mbeturinave vërejmë që përbërja e mbeturinave në vitin 2021 nuk do të ndryshojë në masë të madhe nga viti 2015. Sasia e mbeturinave organike do të pësojë rënie për 2%, mbeturinat nga metalet do të mbesin përafërsisht në sasinë e njëjtë, mbeturinat nga qelqi do të pësojnë një ngritje të lehtë në sasi për 0.25%, mbeturina e plastikës/PET do të ngritet për 1.1%, gjithashtu edhe mbeturinat nga letra/kartoni do të pësojë një ngritje të lehtë prej 0.75%, dhe mbeturinat nga druri do të qëndrojnë në sasi të përafërt.

3.7 Deponimi i mbeturinave

KRM Ambienti, njësia në Klinë i deponon mbeturinat në komunën e Pejës, në deponinë komunale në Sferkë. Deponia komunale në fshatinë Sferkë të Pejës menaxhohet nga komuna e Pejës.

Harta Nr. 5: Pozicioni i deponisë në Sferkë dhe largësia (Burimi: Asa studimi)



Komuna e Klinës nuk posedon transfer stacion. Cdo kamion udhëton cdo ditë ne deponinë e Pejës për të deponuar mbeturinat e grumbulluara gjatë ditës. Distanca mesatare që cdo kamion duhet të përshkojë është 40 km, vajtje dhe ardhje nga Klina.

3.8 Trajtimi dhe riciklimi

Në komunën e Klinës nuk ka trajtim apo reciklim të mbeturinave. Momentalisht ekzist vetëm një kompani private e cila shërben si lokacion ku qytetarët e Klinës mund të shesin mbetjet e tyre nga metalet/skrup. Në komunën e Klinës kemi grumbullim dhe transportim të mbeturinave.

3.9 Mbeturinat shtazore dhe medicinale

3.9.1 Mbeturinat shtazore

Edhe pse mbeturinat shtazore duhet të grumbullohen dhe transportohen me automjete të vecanta, në komunën e Klinës këto mbeturina grumbullohen dhe transportohen së bashku me mbeturinat e tjera komunale. Për më shumë deponimi dhe trajtimi i tyre nuk bëhet në mënyrë të vecantë nga mbeturinat komunale mirëpo ato përfundojnë së bashkë në një deponi, në deponinë e Sferkës, Pejë.

3.9.2 Mbeturinat medicinale

Mbeturinat medicinale janë përgjegjësi e nivelit qendror, mirëpo në komunën e Klinës një pjesë e tyre deponohen në kontenjerat 1.1m³.

Sipas informatave nga QKMF në komunën e Klinës, kjo QKMF posedon marrëveshje me Spitalin Regjional në Pejë për të trajtuar mbeturinat në këtë qendër. Komuna e Klinës gjeneron 40 kg mbeturina medicinale në javë, të cilat mbeturina transportohen në Spitalin Regjional të Pejës dy herë në javë.


3.10 Deponitë ilegale – mbeturinat ndërtimore

Sipas Ligjit për Mbeturina nr. 04/60, deponitë ilegale definojnë si cdo pike e mbeturinave të cilat gjenden jashtë deponive legale për mbeturina.

Organizata ndërkombëtare GIZ, konkretisht projekti Shërbimet e Qendrueshme Komunale (ShQK) në vitin 2016 ka organizuar një vizitë në terren për të identifikuar numrin, llojin dhe lokacionin e deponive ilegale në komunën e Klinës. Duke marrë parasysh që Ligji për Mbeturina nuk ofron ndonjë definicion më detal për deponi ilegale, projekti GIZ/ShQK ka dhënë definicionet si në vijim:

- Deponi ilegale definojnë cdo pikë e mbeturinave që gjendet jashtë deponive legale e cila tejkalon sasinë e 200l – apo sasi e mbeturinave që do të tejkalonte sasinë që do të nxinte një karroc dore.
- Deponitë ilegale ndahen sipas madhësisë si në vijim:
 - Deponi ilegale e vogël: 1 – 5 qese nga 200l apo 1 – 5 karroca dore
 - Deponi ilegale e mesme: 6 – 20 qese nga 200l apo 6 – 20 karroca dore
 - Deponi ilegale e madhe: më shumë se 20 qese nga 200l apo mbi 20 karroca dore
- Llojet e deponive ilegale:
 - Mbeturina komunale
 - Mbeturina ndërtimore
 - Mbeturina të rrezikshme
 - Mbeturina të vëllimshme

Harta Nr. 7: Lokacionet e deponive ilegale në komunë



Rezultatet e vizitës në terren tregojnë që në komunën e Klinës në Prill të vitit 2016 ekzistojnë 57 deponi ilegale (shih hartën 7). Shpërndarja e tyre gjeografike është e rastësishme, pra pothuajse janë të shpërndara në të gjithë territorin e komunës në mënyrë të njëtrajtshme përveç përreth qytetit të Klinës ku kemi në dendësi më të lartë të deponive ilegale.

Nga hulumtimi në terren rezulton që 57 deponi ilegale sipas madhësisë kanë këtë përbërje:

- Të vogla: 2 deponi ilegale
- Të mesme: 29 deponi ilegale
- Të mëdha: 26 deponi ilegale

Ndërsa sipas llojit kanë këtë përbërje:

- Mbeturina komunale: 24 deponi ilegale
- Mbeturina ndërtimore: 32 deponi ilegale
- Mbeturina të rrezikshme: 1 deponi ilegale

4 Performanca e ofruesit të shërbimeve

4.1 Mbledhja dhe transporti i mbeturinave

4.1.1 Stafi, makineritë dhe asetet

Numri i total i punëtorëve në njësinë e KRM Ambienti në Klinë është 30: menaxheri, zyrtari financiar, zyrtari për klient, kryepuntori, 7 Inkasanta, 5 vozitësa, 10 puntor fizik, 4 roje të autoparkut. Numri i automjeteve është 4 kamionë (shih tabelën në vijim).

Tabela Nr. 9: Lista e aseteve të njësis së KRM Ambienti në Klinë

Nr	Automjeti	Rexhistrimi	Funksioni	Kapaciteti	Gjendja e automjetit
1	Iveco Calabrese	03 – 676 – AH	Mbeturina	7.0 t	E mirë
2	Mitsubishi 4	03 – 480 – CA	Mbeturina	4.0 t	E mirë
3	Mercedes	03-291-CA	Mbeturina	7.0 t	E mirë
4	Mitsubishi		Mbeturina	4.0 t	E keqe
5	Mercedes		Mbeturina	7.0 t	E keqe
6	Vetura Fiat Clio		Zyre		-

4.2 Performanca e të hyrave dhe arkëtimit

4.2.1 Tarifat për grumbullim, transportim dhe deponim të mbeturinave

Komunat janë të obliguara që sipas Ligjit mbi Mbeturinat të përcaktojnë tarifat për grumbullim, transportim dhe deponim të mbeturinave. Pavarësisht kësaj kërkesë ligjore komuna e Klinës ende nuk i ka përcaktuar tarifat. Momentalisht në zbatim janë tarifat e vitit 2005 të përcaktuara nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZrrUM). KRM Ambienti, njësia në Klinë aplikon tarifat në vijim për klientët e saj.

Tabela Nr. 10: Tarifat aktuale

	Kategoria e klienteve	Tarifat aktuale		
		Euro/muaj	Euro/zbrazeje 1.1m³	Euro/zbrazeje 7m³
1	Amvisëritë	5.65		
2	Konsumatorët komercial			
2a	Veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese	5.3		
2b	Veprimtaritë e vogla dhe të mesme komerciale	9.2		
2c	Veprimtaritë e mesme dhe të mëdha komerciale	12.8		
2d	Konsumatorët me kontrata të vecanta		12.0	36.8
3	Institucionet		12.0	36.8

4.2.2 Të hyrat, arkëtimi dhe mbulimi i kostove

KRM Ambienti NjO Klinë siguron të hyrat nga shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ndërsa për dallim prej komunave tjera ajo nuk merr asnjë shumë nga shërbimi i pastrimit të rrugëve qka paraqet një anomali në vetëvete.

Arkëtimi i mjeteve nuk është e kënaqshme për amvisëri dhe biznese ndërsa shkalla e prezantuar e arkëtimit për institucione është e fryer për faktin se kompania ka grumbulluar borxh të vjetër i cili është raportuar në periudhën aktuale.

Me të hyrat e arkëtuara kompania është në gjendje ti mbuloj kostot e shërbimit edhe pse kjo kosto nuk përfshin kostot e deponimit të mbeturinave si dhe kostot investive. Në rast se kompania synon që ti mbuloj këto kosto ajo duhet të zgjerojë bazën e shërbimeve, ngrisë shkallën e arkëtimit si dhe të optimizoj kostot e shërbimit.

Të dhënat për vitin 2015		
1	Të hyrat	287,835
1a	Amvisëritë	213,700
1b	Biznesi	41,834
1c	Institucionet	32,301
1d	Të hyrat nga grumbullimi i mbet.	287,835
1f	Të hyrat nga pastrimi i rrugëve	0.0
2	Arkëtimi	188,036
2a	Amvisëritë	111,461
2a	Amvisëritë %	52.2%
2b	Biznesi	26,838
2b	Biznesi %	64.2%
2c	Institucionet	49,737
2c	Institucionet %	154.0%
2d	Grumbullimi i mbeturinave	188,036
2f	Pastrimi i rrugëve	0.0
3	Kostot e shërbimit të MM	181,795
3a	Kostot e grumbullimit	160,459
3b	Kostot e pastrimit	21,336
3c	Kostot e deponimit	0.0

4.3 Të dhëna të përgjithshme financiare mbi menaxhimin e mbeturinave

4.3.1 Performance e Kamionëve

Performanca e kamioneve në operim të Njesisë Operative në Klinë është dhënë në tabelën e mëposhtme dhe të dhënat i referohen vitit 2015. Sasitë e mbeturinave janë dhënë në bazë të matjes me peshoren e instaluar në deponinë Sverkë e Thatë ku njësia i dërgon mbeturinat e grumbulluara. Kompania operon me katër kamionë për grumbullimin e mbeturinave ndërsa funksioni i transferit nuk zbatohet për momentin.

Tabela Nr. 11: Performanca e kamionëve

Tipi i automjeteve							Te gjitha automjetet e zones	
	IVECO Calabrese		Mercedes		Mitsubishi			
	03-471-CS		03-291-CA		03-871-DQ			
Performanca	tons	trips	tons	trips	tons	trips	tons	trips
Janar	195	40	110	30	110	32	415	102
Shkurt	200	43	120	30	120	34	440	107
Mars	205	42	130	20	130	30	465	92
Prill	237	53	223	42	113	25	573	120

Maj	238	49	187	35	174	40	599	124
Qershor	240	56	200	48	160	38	600	142
Korrik	250	60	210	47	140	32	600	139
Gusht	269	63	206	53	128	25	603	141
Shtator	261	55	256	51	122	24	639	130
Tetor	162	56	209	54	148	30	519	140
Nëntor	258	45	211	41	66	16	535	102
Dhjetor	220	50	225	40	153	40	598	130
Total vjetore	2,735	612	2,287	491	1,564	366	6,586	1,469
Mesatarja mujore	228	51	191	41	130	31	549	122
Mesatarja ditore	10.9	2.4	9.1	1.9	6.2	1.5	26.1	5.8
Ngarkesa mesatare për udhëtim	4.5 t/trip		4.7 t/trip		4.3 t/trip		4.5 t/trip	
Mesatarja e km për udhëtim	42 km/trip		81 km/trip		37 km/trip		64 km/trip	
Total kilometra	25,704 km/a		39,771 km/a		13,542 km/a		79,017 km/a	

4.3.2 Kostot e Pajisjeve

Në tabelën në vijim janë të kalkuluara kostot kapitale për pajisjet e grumbullimit të mbeturinave që përfshijnë kamionët dhe kontejnerët. Kostot historike janë nxjerrun nga kontabiliteti ndërsa norma e amortizimit vjetorë është llogaritur si herësi në mes kostos historike dhe jetëgjatësisë së pajisjes. Vlera e mbetur e pajisjes paraqet mbetjen në mes kostos historike të përvetësimit dhe zhvlerësimit të akumuluar. Jetëgjatësia për kamionë është marrë 7 vite ndërsa për kontejnerë ajo është adoptuar 3 vite.

Tabela Nr. 12: Kostot e pajisjeve

Tipi i automjeteve							Te gjitha automjetet e zones	
	IVECO Calabrese		Mercedes		Mitsubishi			
	03-471-CS		03-291-CA		03-871-DQ			
	IVECO Calabrese 7		Mercedes		Mitsubishi			
Kostot e Pajisjeve	IVECO Calabrese 7		Mercedes		Mitsubishi			
Çmimi i Blerjes te Kamionit/Jeta e mjetet	70,000 €	16 years	10,000 €	17 years	40,000 €	5 years	Kosto fillest.	120,006 €
Çmimi i Blerjes te kontejnerëve	60,000 €	9 years	20,000 €	1 years	20,000 €	1 years	Kosto fillest.	100,006 €
Zhvleftësimi Vjetor	11,042 €		20,588 €		28,000 €		59,644 €	
Tatimet, Sigurimi Mirëmbajta.	660 €		410 €		660 €		1,730 €	
Mirëmbajtja e rregullt	2,300 €		1,800 €		2,000 €		6,100 €	
Mirëmbajtja ne përgjithësi	1,700 €		900 €		1,500 €		4,100 €	
Kostot tjera direkte te pajisjeve	4,660 €		3,110 €		4,160 €		11,930 €	

4.3.3 Kostoja e Stafit

Kostot e stafit përfshijnë kostot e stafit të angazhuar direkt në grumbullimin dhe transferin e mbeturinave. Këtu përfshihen pagat, kontributet sociale dhe përfitimet tjera eventuale për mbikëqyrësit, vozitësit dhe personelin tjetër të angazhuar në ofrimin e shërbimit. Tabela në vijim jep kostot e stafi të angazhuar.

Tabela Nr. 13: Kostoja e stafit

Tipi i automjeteve							Te gjitha automjetet e zones	
	IVECO Calabrese		Mercedes		Mitsubishi			
	03-471-CS		03-291-CA		03-871-DQ			
Kostoja e stafit	IVECO Calabrese 7		Mercedes		Mitsubishi			
Stafi	no.	€/month	no.	€/month	no.	€/month	no.	€/month
Mbikëqyrës	1	405 €	0	0 €	0	0 €	1	405 €
Vozitës	1	325 €	1	325 €	1	325 €	10	975 €
Punëtor	2	285 €	2	285 €	2	285 €	23	855 €
Total Kosto e Stafit	15,600 €		10,740 €		10,740 €			37,080 €

4.3.4 Kostot e Materialit Harxhues

Njësia Operative e Klinës ishte në gjendje të sigurojë të dhënat në lidhje me inputet operative për çdo lloj automjeti. Sistemi i monitorimit të brendshëm gjeneron të dhëna për konsumin specifik të naftës (l / 100 km) vajit të motorit (l / 1,000 km), vajit hidraulik (l / 1,000 km), gomave (njësi / 10,000 km) dhe baterive (njësi / 20.000 km). Çmimet njësi për produktet standarde operative të siguruar në tregun vendor, janë dhënë për të llogaritur kostot direkte vjetore të materialeve harxhuese për grumbullimin e mbeturinave.

Tabela Nr. 14: Kostoja e materialit harxhues

Tipi i automjeteve				Te gjitha automjetet e zones
	IVECO Calabrese	Mercedes	Mitsubishi	
	03-471-CS	03-291-CA	03-871-DQ	
Kosto e materialit harxhues	IVECO Calabrese 7	Mercedes	Mitsubishi	
Dizel	10,179 €	15,749 €	3,352 €	29,280 €
Vaj	450 €	696 €	135 €	1,281 €
Vaj Hidraulik	617 €	955 €	203 €	1,775 €
Goma	2,313 €	3,579 €	975 €	6,868 €
Bateri	154 €	239 €	81 €	474 €
Kosto Totale e Materialit Harxhues	13,713 €	21,218 €	4,746 €	39,677 €

4.3.5 Përmbledhja e Kostove Direkte të Grumbullimit dhe Transferit

Tabela e mëposhtme i ka të përmbledhura kostot direkte të shërbimit të grumbullimit dhe transferit të mbeturinave. Këto kosto përfshijnë kostot direkte të stafit të angazhuar, kostot e

amortizimit të pajisjeve dhe kostot e materialit harxhues ku shihet se kostoja njësi për grumbullimin dhe transferin e mbeturinave është 22.5 Euro/ton!

Tabela Nr. 15: Përmbledhja e kostove direkte

Tipi i automjeteve				Te gjitha automjetet e zones
	IVECO Calabrese	Mercedes	Mitsubishi	
	03-471-CS	03-291-CA	03-871-DQ	
Kostot direkte te Mbledhkes se	FORD 1826	FORD 1826	Mitsubishi FE 85	
Mjetet direkte te MM/Zhv.Vjetor	11,042 €	20,588 €	28,000 €	59,644 €
Mjetet tjera te MM/Zhv.Vjetor	4,660 €	3,110 €	4,160 €	11,930 €
Kostot e Stafit 1 vozites dhe 2 punëtor	15,600 €	10,740 €	10,740 €	37,080 €
Kosto e Mat.Harxhues	13,713 €	21,218 €	4,746 €	39,677 €
Total Kostot vjetore e Mbledhjes	45,015 €	55,656 €	47,646 €	148,331 €
Kostot Mesatare pe Ton	16.46 €/ton	24.34 €/ton	30.46 €/ton	22.52 €/ton
Kostot Mesatare për një Udhëtim	73.55 €/trip	113.35 €/trip	130.18 €/trip	100.97 €/trip
Kostot Mesatare për KM	1.75 €/km	1.40 €/km	3.52 €/km	1.88 €/km

4.4 Kostot Totale të Shërbimit

Kostoja totale e shërbimit përfshin përpos koston së grumbullimit dhe transferit edhe kostot e deponimit të mbeturinave si dhe pastrimit të rrugëve. Kostot totale të shërbimit përfshijnë edhe kostot e përgjithshme dhe administrative. Kostot totale të shërbimit janë dhënë sipas zërave sa vijon:

4.4.1 Kostoja e Infrastrukturës

Kostoja e infrastrukturës përfshin pajisjet për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transferit dhe deponimit të mbeturinave. Përveq kësaj në kosto është përfshirë edhe shërbimi i pastrimit të rrugëve. Tabela e mëposhtme përfshin koston totale të shërbimit. Kostot historike janë nxjerrun nga kontabiliteti ndërsa norma e amortizimit vjetorë është llogaritur si herësi në mes koston historike dhe jetëgjatësisë së pajisjes. Vlera e mbetur e pajisjes paraqet mbetjen në mes koston historike të përvetësimit dhe zhvlerësimit të akumuluar.

Tabela Nr. 16: Kostot totale të pajisjeve

Specifikacionet e mjeteve		Njesi	Kapaciteti		% ne MMN	Viti i blerjes	Çmimi i blerjes në €	Vlera aktuale (e kontabilitetit) në €	Jetëgjatësi a e mbetur (vite)	Kostoja vjetore e Zhvlerësimit
			m³	ton						
Grumbullimi	Iveco	1	20	8	100%	2000	70,000 €	18,000 €	3	6,000 €
	Mercedes	1	20	8	100%	1980	10,000 €	18,000 €	3	6,000 €
	Mitsubishi	1	10	7	100%	2012	40,000 €	13,000 €	3	4,333 €
	Kontenjera 1.1m³	140		1	100%	2010	28,000 €	34,000 €	2	17,000 €
	kontejera 120 l	2000		120l	100%	2015	42,000 €	6,000 €	2	3,000 €
	120 lopata +2 fshesa				100%	2016	40 €			0 €

	Shporta	35		100%	2014	35 €			0 €
	Subtotali Grumbullimi					190,075 €	89,000 €		36,333 €
Transferi				100%					0 €
				100%					0 €
				100%					0 €
	Subtotal Transferi					0 €	0 €		0 €
Deponia				100%					0 €
				100%					0 €
				100%					0 €
	Subtotal Deponia					0 €	0 €		0 €
Pastrimi i rrugëve				100%					0 €
	Fshisa lopata	56		100%	2015	204 €	204 €	1	204 €
	Shporta	120		100%	2014	1,320 €	1,320 €	3	440 €
				100%					0 €
				100%					0 €
	Subtotal Pastrimi					1,524 €	1,524 €		644 €
Punëtorja				100%					0 €
				100%					0 €
				100%					0 €
				100%					0 €
	Subtotal Punëtorja					0 €	0 €		0 €
Total Kosoto e Pajisjeve						0 €	0 €		36,977 €

4.4.2 Kostoja e Stafit Direkt

Kostoja e Stafit Direkt i atribuohet stafit të angazhuar drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve dmth stafit operativ i cili mundë ti alokohet kosto qendrave si grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave. Stafi i angazhuar në pastrimin e rrugëve dhe shërbimeve tjera komunale poashtu është i përfshirë si staf direkt.

Tabela Nr. 17: Kosotoja e stafit direkt

Zona e shërbimit dhe pozita e stafit		Nr.	% ne MMN	Rroga bazë €/muaj	Benifite t sociale €/muaj	Gjithsej kostoja direkte për staf për vitin 2015			
						€/muaj	muaj/vit	€/vit	€/vit
Mbledhja	Mbikqyres	1	50%	380 €	25 €	405 €	12	4,860 €	4,860 €
	Vozites	3	100%	300 €	25 €	325 €	12	11,700 €	11,700 €
	Punetore	6	100%	260 €	25 €	285 €	12	20,520 €	20,520 €
	Nentotali Grumbullimi	10						37,080 €	37,080 €
Transferi									

	Nentotali Transferi	0						0 €	0 €
Deponia	Punetore					0 €	12	0 €	0 €
						0 €	12	0 €	0 €
						0 €	12	0 €	0 €
	Nentotali Deponia	0						0 €	0 €
Pastrimi	Mbikqyres	1	50%	380 €	25 €	405 €	12	4,860 €	2,430 €
	Punetore	2	100%	260 €	50 €	310 €	12	7,440 €	7,440 €
						0 €	12	0 €	0 €
	Nentotali Pastrimi	3						12,300 €	9,870 €
Total Kosto Direkte e Stafit								49,380 €	46,950 €

4.4.3 Kostoja e Materiali Harxhues

Kostoja totale e materialit harxhues është dhënë sa vijon për shërbimet e grumbullimit dhe transferit të mbeturinave si dhe deponimit të tyre. Kostot e materialit harxhues janë dhënë edhe për shërbimin e pastrimit të rrugëve.

Tabela Nr. 18: Kostoja e materialit harxhues

Zona e shërbimit dhe lloji i artikullit të shpenzueshëm		Sasia	Kostoja për njësi €/copë	Kostoja aktuale 2015
Mbledhja e mbeturinave	Karburant			34,373 €
	Vaj motorri			800 €
	Vaj hidraulik			397 €
	Bateri			360 €
	Goma			1,826 €
	Nentotali Grumbullimi			37,756€
Transferi		0.0 l	0.00 €	0 €
		0.0 l	0.00 €	0 €
	Nentotali Transferi			0
Deponia		0.0 l	0.00 €	0 €
		0.0 l	0.00 €	0 €
		0.0 l	0.00 €	0 €
	Nentotali Deponia			0€
Pastrimi i rrugëve	Uniformat	20 no.	60.00 €	1,200 €
	Dorezat	350 no.	1.00 €	350 €
	Kepucet	18 no.	16.00 €	288 €
				0 €
	Nentotali Pastrimi			1,838€
Punetoria				0 €
				0 €
	Nentotali Punetoria			0 €

Totali:			39,594 €
----------------	--	--	-----------------

4.4.4 Kostoja e Stafit Indirekt

Personeli i cili është i përfshirë vetëm në mënyrë indirekte në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, por gjeneron kosto të cilat duhet të alokohen pjesërisht për qendrat e kostos, si grumbullimin, transferimin dhe deponi. Në mënyrë që të vlerësohet kostoja totale vjetore e stafit indirekt, janë marrë si bazë pagat themelore dhe përfitimet sociale të paguara në baza mujore për poste të ndryshme.

Tabela Nr. 19: Kostoja e stafit indirekt

Zona e shërbimit dhe posti i stafit		Nr.	Rroga bazë €/muaj	Mëditjet €/muaj	Gjithsej kostoja direkte për staf 2015		
					€/muaj	muaj/vit	€/vit
Menaxhmenti	Menaxheri i përgjithshëm	1	580 €	0 €	580 €	12	6,960 €
			0 €	0 €	0 €	12	0 €
				0 €	0 €	12	0 €
	Nentotali Stafi i Menaxhmentit	1					6,960 €
Administrata	Kontabiliste	1	420 €	0 €	420 €	12	5,040 €
	Inkasant	7	300 €	0 €	300 €	12	25,200 €
	Referent - faturist		0 €	0 €	0 €	12	0 €
	Zyrtar me merdhenie me publikun	1	390 €	0 €	390 €	12	4,680 €
	Nentotali Stafi Administrativ	9					34,920 €
Punetoria			0 €	0 €	0 €	12	0 €
			0 €	0 €	0 €	12	0 €
	Nentotali Stafi i Punetorise	0					0 €
Sigurimi	Sigurimi	4	260 €	0 €	260 €	12	12,480 €
				0 €	0 €	12	0 €
	Nentotali Stafi i Sigurimit	4					12,480 €
Total i Shpenzimeve Indirekte per Staf		14					54,360 €

4.4.5 Kostot tjera indirekte dhe administrative

Kostot tjera indirekte dhe administrative janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr. 20: Kostot tjera indirekte

Lloji i shpenzimeve të tjera indirekte	Gjithsej kostoja aktuale 2015	Përqindja në MMN	Shpenzimet aktuale 2015
	€/viti	%	€/viti
Tatime	0 €	100%	0 €
Sigurim	0 €	100%	0 €
Telefon, internet, rryme	0 €	100%	0 €
Office equipment	800 €	100%	800 €

Communication (Telefon, Internet)	684 €	100%	684 €
Borxhe Tatimore	0 €	100%	0 €
Rryma per Administrate	0 €	100%	0 €
Totali:			1,484 €

4.4.6 Përmledhje e Kostos Totale të Shërbimit

Kostoja totale e shërbimit është dhënë në tabelën e mëposhtme. Kostoja totale e shërbimit për Njësinë Operative Klinë është 181,795 Euro. Ngarkesa mujore për amvisëri për gjithë zonën e shërbimit është 3.02 Eur/muaj por kjo shumë do të ishte substancialisht më e lartë nëse kompania do të shpenzonte fonde për investime kapitale dhe do të paguante taksën e deponimit të mbeturinave.

Tabela Nr. 21: Kostot totale të shërbimit

Lloji i shpenzimeve		Shpenzimet vjetore 2015									
		Grumbullimi i mbeturinave		Transferi		Deponia		Pastrimi i rrugeve, etj		Shpenzimet totale	
Direkt	Pajisjet Operative(Zhvleftësimi)	36,333 €		0 €		0 €		644 €		36,977 €	
	Stafi operativ	37,080 €		0 €		0 €		12,300 €		49,380 €	
	Mat.Harxhues për Operime	37,756 €		0 €		0 €		1,838 €		39,594 €	
	Shpenzimet operative	88%	111,169 €	0%	0 €	0%	0 €	12%	14,782 €	100%	125,951 €
Indirect	Garazhe(Zhvleftësimi)	0 €								0 €	
	TS (Zhvlevesimi)			0 €						0 €	
	Ndërtesa ne Deponim (Zhvleftësimi)					0 €				0 €	
	Punëtorja, Dyqani(Zhvleftësimi)	0 €		0 €		0 €		0 €		0 €	
	Ndërtesa Administrata (zhvleftësimi)	0 €		0 €		0 €		0 €		0 €	
	Pajisja Punëtorja(Zhvleftësimi)	0 €		0 €		0 €		0 €		0 €	
	Mjetet e Konsumit (Punëtorja)	0 €		0 €		0 €		0 €		0 €	
	Stafi Indirekt	47,980 €		0 €		0 €		6,380 €		54,360 €	
	Kostot Tjera Indirekte	1,310 €		0 €		0 €		174 €		1,484 €	
	Shpenzimet indirekte - subtotali	88%	49,290 €	0%	0 €	0%	0 €	12%	6,554 €	100%	55,844 €
Total Kostot e SHMM		88%	160,459 €	0%	0 €	0%	0 €	12%	21,336 €	100%	181,795 €
Performanca:Grumbullim /Transferim/Deponim		6,586 t/a		0 t/a		6,586 t/a				6,586 t/a	
Kostot direkte për njësi		17 €/t		0 €/t		0 €/t				17 €/t	
Kostot Indirekte për Njësi		7 €/t		0 €/t		0 €/t				7 €/t	
Kostot Totale për njësi		24 €/t		0 €/t		0 €/t				24 €/t	
Popullata e shërbyer		Kostoja Mesatare e MMN per Amviseri per Muaj									
5,019 Amisëri		Grumbullimi		Transferi		Deponia		Pastrimi		Shpenzimet totale	
Kostot direkte		1.85 €		0.00 €		0.00 €		0.25 €		2.09 €	

Kosto Indirektë	0.82 €	0.00 €	0.00 €	0.11 €	0.93 €
Total Kostot e SHMM	2.66 €	0.00 €	0.00 €	0.35 €	3.02 €
Total Kostot e SHMM	Grumbullimi - Transferi - Deponimi		2.66 €	0.35 €	3.02 €

4.5 SWOT analiza

Përparësitë	Mangësitë
- Shkallë relativisht e mirë e mbulimit të territorit me shërbime – 73% të popullatës kanë qasje në shërbime. - Organizim i mirë territorial i shërbimit të menaxhimit të mbeturinave – komuna e ndarë në 7 zona të shërbimit. - Sistem relativisht i mirë i grumbullimit të mbeturinave: 21 vendbanime me qese, 5 me 1.1m³ dhe 27 vendbanime me kontejnera 120 l. 2000 kontejnera 120 l janë të rinj - Sasi e konsiderueshme e mbeturinave për reciklim 60% – 65%. - Disponimi i komunës të marrë përgjegjësi në menaxhim të mbeturinave. - Zgjidhje e mirë për deponim, deponia në distance të pranueshme sipas standardeve - Inkasimi në fshatëra relativisht i mirë	- Kontejnerët 1.1m³ të amortizuar. - Numër i pamjaftueshëm i kontejnerëve - Udhëtim ditor i të gjitha mjeteve, trafiku i ngarkuar gjatë transportimit për në deponinë e Pejës, Sferkë – 40km në të dy drejtimet. - Të gjitha automjetet transportuese të amortizuara. - Nuk ka aktivitete të organizuara për ndarje apo/dhe reciklim. - Mbeturinat shtazore mbledhen dhe deponohen së bashku me mbeturinat komunale. - Një pjesë e mbeturinave medicinale përfundojnë në kontejnera të përbashkët 1.1m³. - Nuk ka hapësirë të vecantë për deponimin dhe trajtimin e mbeturinave ndërtimore. - Kualiteti i shërbimeve të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave. - Baza e të dhënave për numër të klientëve dhe sasi të mbeturinave e paqartë. - Nuk ka informata të sakta për sasinë e saktë të gjenerimit të mbeturinave për amvisëri, biznese dhe institucione. - Numër i madh i deponive ilegale (57) duke marrë parasysh mbulueshmërinë mjaftë të mirë me shërbime. - Shkallë e ulët e inkasimit: amvisëritë 52% ; bizneset 72%; dhe institucionet 62%, posaqërisht në qytet - Nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet e shërbimit të mbeturinave. - Komuna nuk ka kontratë valide me operatorin për shërbime të menaxhimit të mbeturinave. - Komuna, konkretisht DSHP ka mungesë të personelit, vetëm drejtori - Komuna nuk ka përckatuar tarifat për

	grumbullim, transportim dhe deponim të mbeturinave. - Nuk ka buxhet të vecantë komunal për menaxhim të mbeturinave. - Ka keqpërdorim të mekanizmit për detyrim të pagesës së mbeturinave - Komuna nuk organizon aktivitete për vetëdijësimin e qytetarëve rreth menaxhimit të mbeturinave.
Mundësitë	Rreziqet
- Qasje në fonde për menaxhim të mbeturinave nga organizatat ndërkombëtare - Dispozitat ligjore mundësojnë që komuna të marrë përgjegjësi shtesë për menaxhim të mbeturinave, psh inkasimi i tarifës.	- Interpretimet e ndryshme ligjore rreth përgjegjësive të komunës për menaxhim të mbeturinave. - Mungesa e mekanizmave adekuat për rritjen e inkasimit të tarifës për grumbullim, transportim dhe deponim të mbeturinave. - Deponitë ilegale, sidomos afër zonave të banimit, rrezikojnë shëndetin e banorëve - Hudhja e mbeturinave në lumenjë, shkakton bllokime dhe me këtë edhe rrezikohen vendbanimet nga vërshimet

4.5.1 Sfidat e menaxhimit të mbeturinave

Komuna e Klinës ka sfida mjaft të mëdha në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Analiza e gjendjes ekzistuese vë në pah disa prej tyre:

- Mbulimi jo i terësishëm me shërbime të grumbullimit të mbeturinave, 70% të popullatës kanë qasje në shërbime. Mbulimi jo i terësishëm me shërbime i atribuohet kapacitetve të mangëta të KRM "Ambienti" që të ofrojë shërbime për të gjithë qytetarët e saj. KRM "Ambienti" posedon makineri të vjetruar dhe infrastrukturë të amortizuar. Në të njejtën kohë, kualiteti i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nuk është në nivelin e duhur. Për komunën e Klinës do të jetë sfida serioze që të adresojë çështjen e ofrimit të shërbimeve për grumbullim të mbeturinave dhe ngritjen e kualitetit të shërbimeve duke marrë parasysh mangësitë e sipërpërmendura dhe kapacitetin financiar të komunës.
- Në mënyrë që sistemi i menaxhimit të mbeturinave të jetë financiarisht i qëndrueshëm duhet patjetër të ndërtohet transfer stacioni në komunën e Klinës apo në komunën e Istogut. Sfidë e vecantë do të jetë lokacioni për transfer stacion si dhe funksionalizimi dhe menaxhimi i tijë.
- Financimi i infrastrukturës dhe makinerisë për menaxhim të mbeturinave del të jetë sfida tjetër për të përmirësuar kualitetin e shërbimeve.
- Inicimi i aktiviteteve për ndarje të mbeturinave është sfida në vete duke marrë parasysh problemet bazike me grumbullim të mbeturinave dhe deponitë ilegale përgjatë gjithë komunës.

5 Plani operacional

5.1 Vizioni

Vizioni është mjet nëpërmes të cilit komuna përcakton kahjet e menaxhimit të mbeturinave në një periudhë më të gjatë kohore. Si i tillë, vizioni fokusohet në gjendjen në të cilën dëshirojë të shohë sektorin e menaxhimit të mbeturinave pas një kohe të caktuar. Vizioni del si rezultat i analizës së gjendjes ekzistuese, përfshi edhe kapacitet ekzistuese të komunës për udhëhequr reformat në këtë sektor. Duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese dhe përmbajtjen e SËOT analizës, vizioni i komunës së Klinës është hartuar si në vijim.

Klina, komunë që ofron shërbime kualitative të menaxhimit të mbeturinave me infrastrukturë të përshtatshme për zvogëlim dhe ndarje të mbeturinave e cila mundëson mbrojtje efektive të mjedisit dhe promovim të zhvillimit ekonomik lokal.

Komuna e Klinës synon që të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave gjithë qytetarëve të saj. Krahas këtij veprimi komuna synon që të ngrisë kualitetin e shërbimeve duke bashkëpunuar më qytetarët e saj dhe akterët tjerë relevant.

Duke promovuar konceptin 3R zvogëlo, ripërdoro, dhe reciklo komuna synon që gradualisht të fillojë të ndajë mbeturinat (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të edukojë qytetarët rreth benefiteve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Përfundimisht, komuna synon që të krijojë një mjedis më të pastër për qytetarët e saj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e mirëqenjes për qytetarë.

5.2 Objektivat e nivelit qendror

Strategjia dhe Plani për Menaxhim të Mbeturinave (MMPH)

Objektivat e komunës së Klinës përveç që adresojnë problemet edhe gjendjen ekzistuese, ato adresojnë edhe objektivat e Strategjisë për Menaxhim të Mbeturinave 2013-2022 si dhe aktivitetet që dalin nga Plani për Menaxhim të Mbeturinave për komunat respektive.

Strategjia për Menaxhim të Mbeturinave 2013 – 2022 përcakton objektivat si në tabelën në vijim.

Tabela Nr. 22: Objektivat për realizimin e qëllimeve e strategjisë³

Qëllimet	Përqindja %/vit			
	2013	2015	2019	2022
Grumbullimi i mbeturinave komunale	50	70	80	90
Ndarja në lloje e mbeturinave komunale	0	20	30	50
Trajtimi i mbeturinave	10	20	35	40
Sasia e mbeturinave të hedhura në deponi	90	80	65	60
Sasia e mbeturinave biodegraduese	95	85	70	40

Niveli qendror, nëpërmes strategjisë ka përcaktuar si objektiv që deri me 2022 grumbullimi i mbeturinave komunale në të gjitha komunat e Kosovës të mbijë në shkallën prej 90%. Sa i përket ndarjes së mbeturinave, strategjia kërkon që deri me 2022 shkalla e ndarjes së mbeturinave të mbërrijë deri në 50%, ndërsa trajtimi i tyre të mbërrijë deri në 40%. Në të njëjtën kohë, strategjia kërkon që sasia e mbeturinave që hedhen në deponi të zvogëlohen deri në 60%, ndërsa që sasia e mbeturinave biodegraduese që hedhen në mbeturina komunale deri në vitin 2022 të zvogëlohet deri në 40%.

³burimi: Strategjia për Menaxhim të Mbeturinave 2013 – 2022

Tabela Nr. 22: Objektivat e strategjisë për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave⁴

Mbeturina	Afati i fundit	Proporcioni (% masore)	
		Ripërdorim	Riciklim
Mbeturinat e ambalazhit	2018 - 2022	40 – 65	40 – 55
Automjetet mbeturinë	2018 - 2021	60 – 70	90 – 95
Mbeturinat elektrike dhe elektronike	2018 – 2021	70 – 80	80 – 90
Mbeturinat e gomës	2018 – 2022	30 – 70	20 – 30
Vajrat mbeturinë	2018 - 2022	40 - 60	-

Strategjia gjithashtu ka përcaktuar objektivat për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave të vecanta. Deri në vitin 2022 mbeturinat e ambalazhit duhet të futen në ripërdorim në masë prej 65% dhe në riciklim në masë prej 55%. Mbetjet elektrike dhe elektronike duhet të arrijnë shkallën e ripërdorimit deri në 80% dhe të riciklimin deri në 90%. Ndërsa mbeturinat e gomës do të duhej të ripërdoren deri në shkallë prej 70% ndërsa riciklim deri në 30%.

Dokumenti tjetër i cili është hartuar nga MMPH dhe rekomandimet e të cilit duhet të përfillen nga Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave është Plani për Menaxhim të Mbeturinave (PMM). PMM si mjet për zbatimin e Strategjisë, për komunën e Klinëska paraparë vetëm një aktivitet konkret. PMM parasheh që në Klinë të ndërtohet transfer stacioni. Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave duhet të identifikojë lokacion të përshtatshëm për ndërtimin e kësaj qendreje.

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave duhet të udhëzojë komunën e Klinës si të përmbushë kërkesat e sipërpërmendura të Strategjisë dhe Planit dhe objektivat e vetë planit komunal duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese, kapacitet investive dhe teknike të komunës.

5.3 Objektivat e PKMM Klinë

Duke u nisur nga objektivat e përcaktuara nga Strategjia e Mbeturinave të Republikës së Kosovës, dhe bazuar në gjendjen ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave në komunën e Klinës, janë paraparë edhe objektivat për këtë komunë. Objektivat e parapara janë të listuara më poshtë dhe të detajuara në vazhdim.

Objektivat janë strukturuar duke marrë parasysh temat të cilat janë analizuar në pjesën e gjendjes ekzistuese dhe me anë të të cilave synohet që të arrihet vizioni i përcaktuar me plan. Në të njëjtën kohë objektivat e PKMM-së reflektojnë në gjendjen ekzistuese dhe problemet në sektor.

Objektivat e parapara janë të listuara më poshtë dhe të detajuara në vazhdim.

Qwllimi 1: Rritja e qwndrueshmwrsw sw sistemit tw menaxhimit tw mbeturinave

- O1: Riorganizimi i zonave për shërbime të grumbullimit të mbeturinave me qëllim të rritjes së efikasitetit të shërbimit në pesë vitet e ardhshme.
- O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime për të gjitha amvisëritë, institucionet dhe bizneset në komunën e Klinës me qëllim të mbulimit të plotë deri në vitin 2019.
- O3: Përmirësimi i infrastrukturës për grumbullim të mbeturinave, duke siguruar kontejner për çdo familje, në mënyrë graduale, deri në plotësim të kërkesave 100%, në fund të vitit 2019.
- O4: Identifikimi i lokacionit për transfer stacion.

⁴Burimi: burimi: Strategjia për Menaxhim të Mbeturinave 2013 – 2022

Qëllimi 2: Inicimi i procesit për ndarje të mbeturinave në burim duke synuar që të zvogëlohet sasia e mbeturinave që përfundojnë në deponi.

- O5: Ndarja e mbeturinave në burim në shkollat publike dhe institucionet publike komunën e Klinës në mënyrë graduale deri në përfshirje 100% në fund të viti 2020.
- O6: Inicimi i ndarjes së mbeturinave në burim, në dy fraksione (të reciklueshme dhe të pa reciklueshme) në një lagje të komunës deri në fund të viti 2021.
- O7: Prezentimi i ishujve të gjelbërt, në qytetin e Klinës, për të mundësuar hedhjen e mbeturinave të ndara në disa fraksione, në 5 lokacione deri në fund të viti 2021.
- O8: Ndërtimi i oborrit të riciklimit, në komunë, për të mundësuar hedhjen e mbeturinave të vëllimshme dhe mbeturinave të vecanta.
- O9: Krijimi i sistemit lokal të kompostimit, përmes sigurimit të komposterëve individual për 700 familje deri në fund të viti 2021.

Qëllimi 3: Grumbullimi, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të vecanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi.

- O10: Grumbullimi dhe transportimi i vecantë i mbeturinave shtazore deri në vitin 2017.
- O11: Krijimi i infrastrukturës së vecantë për mbeturina medicinale deri në fund të vitit 2017.
- O12: Lokacioni për ndërtimin e qendrës për trajtimin e mbeturinave ndërtimore është definuar.

• Qëllimi 4: Eliminimi i deponive ilegale në komunë, sanimi dhe parandalimi i rikrijimit të tyre, me qëllim të ruajtjes së ambientit dhe parandalimit të emergjencave mjedisore

- O13: Eliminimi i deponive ilegale gjatë vitin 2017, dhe parandalimi i krijimit të tyre në vazhdimësi.

Qëllimi 5: Konsolidimi i strukturës brenda komunës për menaxhim të mbeturinave si dhe vendosja dhe zhvillimi i procesit të planifikimit dhe implementimit të PKMM.

- O14: Reformat administrative
 - O14.1 Themelimi i njesisë së menaxhimit për mbeturina
 - O14.2 Miratimi i rregullave për menaxhim të mbeturinave
- O15: Analiza e të hyrave të kompanisë nga tarifa për grumbullim, transportim dhe deponim të mbeturinave, dhe shërbimet tjera

Qëllimi 6: Vetëdijësimi

- O16: Krijimi i kampanjës për vetëdijësim dhe informim rreth efekteve pozitive dhe negative të mbeturinave, rreth orarit dhe rregullave të grumbullimit dhe hedhjes së mbeturinave.

Në vijim secili nga objektivet është i shtjelluar dhe i elaboruara në veqanti

Në vijim secili nga objektivet është i shtjelluar dhe i elaboruara në veqanti

5.3.1 Shkalla e mbulueshmërisë me shërbime


5.3.1.1 O1: Riorganizimi i zonave për shërbime të grumbullimit të mbeturinave me qëllim të rritjes së efikasitetit të shërbimit në pesë vitet e ardhshme.

Objekti i parë dhe më i rëndësishmi është riorganizimi i zonave për shërbim. Riorganizimi i zonave për shërbim të grumbullimit të mbeturinave do t'i paraprijë rritjes graduale të mbulueshmërisë me shërbime. Nëse nuk kemi riorganizim efikas të zonave për shërbime, atëherë as rritja graduale e shërbimeve nuk mund të zbatohet si duhet. Riorganizimi nënkupton analizë të rrjetit të rrugëve, shpërndarjes hapësinore dhe lokacionit të transfer stacionit. Në të njëjtën kohë, riorganizimi do të merr parasysh edhe numrin e vendbanimeve, sasinë e mbeturinave për cdo vendbanim dhe ditët e shërbimit.

Momentalisht, komuna e Klinës shërbehët në gjashtë zona, përfshi edhe qytetin. Riorganizimi i zonave të shërbimit është më së i nevojshëm në mënyrë që të optimizohen shpenzimet operative dhe amortizimi i automjeteve, dhe të ngritet kualiteti i shërbimeve.


Ashtu siç është paraqitur në gjendjen ekzistuese, në komunën e Klinës nuk janë në shërbim 3 fshatra. Riorganizimi nënkupton futjen në sistem të shërbimit edhe të këtyre fshatrave të cilat nuk shërbehen.

Figura. Nr. 2: Koncepti i riorganizimit të shërbimit



Koncepti i ndarjes së komunës së Klinës në zona të shërbimit fillon nga qyteti. Qyteti konsiderohet si pikë qendrore ku ofrohet shërbim i kombinuar – një ditë në javë dhe shtatë ditë në javë - duke marrë parasysh dendësinë e banorëve dhe sasinë e mbeturinave. Si i tillë, qyteti qendron si zonë e ndarë e shërbimit nga fshatrat. Nga qyteti pason ndarja e komunës në zona tjera të shërbimit. Ndarja e fshatrave në zona bazohet në rrjetin rrugor aktual, në ditët e punës për shërbim, sasinë e mbeturinave të gjeneruara për zonë, dhe përgjegjësitë e ndara për zonë – me përgjegjësi nënkuptohet që cdo zonë parimisht të ketë të makinerinë që do ta shërbente atë zonë. Në këtë mënyrë, komuna do të ketë më të lehtë të shërbejë zonat sipas ditëve të javës, futjen e operatorëve tjerë në shërbim – nëse paraqitet nevoja - dhe monitorimin e punës së operatorëve që e kryejnë shërbimin.

Harta Nr. 8: Zonat e shërbimit për grumbullim të mbeturinave në komunën e Klinës



Duke u bazuar në konceptin e sipërpërmendur, komuna e Klinës ndahet në 6 zona të shërbimit përfshi edhe qytetin si zonë e vecantë. Zonat janë të ndara si në vijim:

- Qyteti (Zona urbane)
- Zona 1: Klinafç, Pgraxhë, Kërnice, Gjurgjevik i Vogël, Shtupel, Ranoc, Leskoc, Dranashiq, Binxhë, Grabç, Jashanicë, Resnik, dhe Jelloc.
- Zona 2: Drsnik, Dush, Siqevë, Gjurgjevik i Madh, Ujmir, Doberdol, Gllarevë, Rixhevë, Zabergjë, Cabiq, dhe Carravik.
- Zona 3: Dollc, Gremnik, Perqevë, Qupevë, Volljak, Sferkë, dhe Dush i Vogël.
- Zona 4: Zajm, Drenoc, Pjetërq i Poshtëm, Pjetërq i Epërm, Dugajevë, Grabanicë, Bokshiq, Dollovë, Qeskovë, dhe Kpuz.
- Zona 5: Deiq, Videjë, Krushevë e Vogël, Jagodë, Raduloc, Krushevë e Madhe, Zllakuqan, Nagllavë, Budisalc, Bërkovë, Rudicë, dhe Stupë.

Harta Nr. 9: Zona urbane



5.3.1.1.1 Zona e qytetit

Zona e qytetit shërbehet si në vijim:

Qendra e qytetit shërbehet cdo ditë pune – nëse ka nevojë edhe gjatë ditës së Shtunë,

- Nënzona 1 të Hënën,
- Nënzona 2 të Martën,
- Nënzona 3 të Mërkurën,
- Nënzona 4 të Enjten, dhe
- Nënzona 5 të Premtën.

Do të thotë që qendra e qytetit do të shërbehet cdo ditë pune të javës ndërsa nënzonat tjera të qytetit do të shërbehën një herë në javë.

Tabela Nr. 23: Objektiave e zgjerimit në vitin 2021

Zona	Vendbanimi	Numri i banorëve 2021	Numri i amvisërive 2021	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/vit	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/javë
	Qyteti	6,002	1,097	1,932	38

Nga tabela shohim që numri i banorëve në qytet në vitin 2021 do të mbërrijë në 6,002 banorë ndërsa gjenerimi i mbeturinave në vitin 2021 në qytet do të arrijë 38 ton në javë. Si bazë planifikimi është marrë viti 2021 për shkak që plani përfshin afatin kohor prej 5 viteve.

5.3.1.1.2 Zonat rurale

Shërbimi në zonat jashtë qytetit do të kryhet një ditë në javë duke filluar nga e Hëna deri te Premten. Cdo zonë do të shërbehet për një ditë në javë, apo cdo amvisëri apo biznes do të shërbehet një herë në javë. Kjo do të thotë e gjithë makineria e nevojshme për shërbim do të fokusohet në një ditë në mënyrë që shërbimi të përfundojë brenda ditës së planifikuar. Në vijim janë paraqitur zonat dhe ditët e shërbimit të tyre, përfshi edhe numrin e banorëve dhe sasisë e gjeneruar për mbeturina.

Tabela Nr. 24: Zona 2 (e shërbyer të Hënën)

Zona	Vendbanimi	Numri i banorëve 2021	Numri i amvisërive 2021	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/vit	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/javë
1	Binxhë	127	21	41	0.79
	Dranashiq	23	4	7	0.14
	Grabç	223	38	72	1.39
	Gjurgjevik I Vogël	807	137	261	5.01
	Jashanicë	1,932	327	624	12.00
	Jelloc	29	5	9	0.18
	Kërnice	860	145	278	5.34
	Klinafc	520	88	168	3.23
	Leskoc	259	44	84	1.61
	Pograxhë	396	67	128	2.46
	Ranoc	382	65	123	2.37
	Resnik	432	73	140	2.68
	Shtupel	835	141	270	5.19
	subtotali	6,825	1,155	2,204	42.39

Tabela Nr. 25: Zona 3 (e shërbyer të Martën)

Zona	Vendbanimi	Numri i banorëve 2021	Numri i amvisërive 2021	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/vit	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/javë
2	Caravik	1,344	227	434	8.35
	Çabiq	933	158	302	5.80
	Dobërdol	367	62	119	2.28
	Drshnik	1,917	324	619	11.91
	Dush	261	44	84	1.62
	Gllarevë	1,932	327	624	12.00
	Gjurgjevik i	486	82	157	3.02
	Rixhevë	942	159	304	5.85
	Siqevë	1,449	245	468	9.00
	Ujmir	589	100	190	3.66
	Zabërgjë	788	133	255	4.90

subtotali	11,009	1,863	3,556	68.38
------------------	---------------	--------------	--------------	--------------

Tabela Nr. 26: Zona 4 (e shërbyer të Mërkurën)

Zona	Vendbanimi	Numri i banorëve 2021	Numri i amvisërive 2021	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/vit	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/javë
3	Dolc	299	51	97	1.86
	Dush i Vogël	212	36	69	1.32
	Gremnik	1,225	164	396	7.61
	Përqevë	1,088	184	352	6.76
	Qupevë	627	106	203	3.89
	Sferkë	2,651	449	856	16.47
	Vulljak	1,006	170	325	6.25
	subtotali	7,108	1,159	2,296	44.15

Tabela Nr.27: Zona 4 (e shërbyer të Enjëten)

Zona	Vendbanimi	Numri i banorëve 2021	Numri i amvisërive 2021	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/vit	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/javë
4	Bokshiq	469	79	151	2.91
	Dollovë	481	81	155	2.99
	Drenoc	476	81	154	2.96
	Dugajevë	432	73	140	2.68
	Grabanicë	788	133	255	4.90
	Kpuz	674	114	218	4.18
	Pjetërq i Epërm	610	103	197	3.79
	Pjetërq i Poshtëm	173	29	56	1.08
	Qeskovë	404	68	130	2.51
	Zajm	1,372	232	443	8.52
	subtotali	5,879	995	1,899	36.52

Tabela Nr. 28: Zona 5 (e shërbyer të Premtën)

Zona	Vendbanimi	Numri i banorëve 2021	Numri i amvisërive 2021	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/vit	Gjenerimi i mbeturinave 2021 t/javë
5	Bërkovë	266	53	86	1.65
	Budisalc	431	73	139	2.68
	Deiq	407	69	132	2.53

Jagodë	213	36	69	1.33
Krushevë e Madhe	634	107	205	3.94
Krushevë e Vogël	350	59	113	2.17
Nagllavë	73	12	23	0.45
Raduloc	382	65	123	2.37
Rudicë	483	82	156	3.00
Stupë	194	33	63	1.20
Videjë	718	121	232	4.46
Zllakuqan	715	121	231	4.44
subtotali	4,866	831	1,572	30.22

Sic u cek më lartë për planifikim të numrit të kamionëve është marrë për bazë parimi: 1 – 3 kamion duhet të shërbejnë një popullatë prej 4,700 – 15,000 banorë. Në të njejtën kohë si bazë është marrë edhe sasia e mbeturinave të cilat i gjencron një zonë. Si bazë për planifikim është marrë edhe zona e cila do të shërbehtë në një ditë, sepse kamionët e njejtë do të shërbejnë të gjitha zonat mirëpo në ditë të ndryshme. Meqenëse zona 2 gjeneron më së shumti mbeturina, atëherë kjo zonë është marrë si zonë bazë për planifikim të kamioneve për grumbullim të mbeturinave në fshatra.


Nga tabelat më lartë shohim që numri i banorëve në zonën 2 në vitin 2021 është 7,108 banorë, ndërsa sasia e gjenerimit të mbeturinave për një javë është 68 ton. Sasia e gjenerimit të mbeturinave për një javë është marrë si indikator për planifikim sepse shërbimi ofrohet një herë në javë, dhe për këtë arsye duhet të planifikohet për kamion që do ta ofrojnë shërbimin komplet për një zonë brenda një dite.

5.3.1.2 O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime për të gjitha amvisëritë, institucionet dhe bizneset në komunën e Klinës, duke e arritë mbulueshmërinë e plotë deri në fund të vitit 2019.

Komuna synon që në periudhen 3 vjecare të mbulojë të gjitha amvisëritë, institucionet dhe bizneset me shërbime të grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave. Rritja graduale nënkupton zgjerim radial të shërbimeve duke e përdorur zonën urbane si qendër. Shërbimet do të zgjerohen filimisht në vendbanimet përreth zonës urbane – qytetit duke vazhduar në vendbanimet më të largëta (shih hartën 10).

Komuna synon që shkallën e shërbimit nga 60% ta rritë në 100% mbulim me shërbime deri fund të vitit 2019. Rritja graduale e shërbimeve do të thotë rritje mesatare prej 16% në vit, kjo rritje nënkupton numrin e amvisërive, institucioneve, dhe bizneseve.

Harta Nr. 10: Ndarja në bazë të zonave të shërbimit



5.3.1.2.1 Faza e parë: viti 2017

Rritja e mbulueshmërisë me shërbime do të bëhet në ato vendbanime të cilat gjenden afër zonës urbane – qytetit (shih hartën 10). Momentalisht në komunën e Klinës një pjesë e madhe e vendbanimeve janë të shërbyera pjesërisht. Në këtë fazë, vendbanimet të cilat gjenden afër qytetit do të mbulohen me shërbime 100%.

Tabela Nr. 29: Faza e parë e zgjerimit të shërbimeve në vitin 2017

	Vendbanimi	Nr. amvisëriv e 2016	Amvisëri të shërbyera 2016	Amvisëri të shërbyera 2016 %	Vlerësimi i rritjes së amvisëriv e 2017	Amvisëritë për t'u përfshi në shërbim 2017	Gjenerimi i mbeturinave 2017 t/javë
Zona 1							
1	Klinafc	85	6	7.1%	85	80	2.9
2	Pograxhë	64	33	51.2%	65	32	2.21
3	Gjurgjevik i Vogël	131	52	39.6%	133	81	4.49
Zona 2							
4	Drshnik	312	43	13.8%	314	274	10.68
5	Dush	42	19	44.8%	43	24	1.45
6	Gjurgjevik i Madh	79	51	64.5%	80	29	2.71
Zona 3							
7	Dollc	49	21	43.2%	49	28	1.66
8	Gremnik	157	108	68.7%	158	52	6.82

	Zona 4						
9	Zajm	223	145	65%	225	82	7.64
10	Drenoc	77	46	59.4%	78	33	2.65
11	Grabanicë	128	65	50.7%	129	65	4.39
	Zona 5						
12	Deiq	66	56	84.6%	67	11	2.27
13	Videjë	117	55	47.1%	118	64	4
14	Krushevë e Vogël	57	49	82.6%	57	9	1.95
15	Raduloc	62	53	85.3%	63	10	2.13
Total		1649	802		1664	874	57.95

Në këtë fazë shërbimi do të zgjerohet 100% në 15 fshatra (shih tabelën më lartë). Përqindja e rritjes së shërbimit krahasuar me numrin e parashikuar të rritjes së amvisërive (6,868 amvisëri) për vitin 2017 është 12.7% apo 874 amvisëri. Sasia e mbeturinave totale për grumbullim është 57.95 ton për javë.

5.3.1.2.2 Faza e dytë: viti 2018

Tabela Nr. 30: Faza e dytë e zgjerimit të shërbimeve në vitin 2018

	Vendbanimi	Nr. amvisëri ve 2016	Amvisëri te sherbyer a 2016	Amvisëri të sherbye ra 2016 %	Vlerësimi i rritjes së amvisëriv e 2018	Amvisëritë për t'u përfshi në shërbim 2018	Gjenerimi i mbeturinav e 2018 t/javë
	Zona 1						
1	Kërnice	140	31	22.2%	142	111	4.92
2	Shtupel	136	60	44.2%	138	78	4.78
3	Dranashiq	4	4	100%	4	0	0.02
4	Jelloc	5	0	0%	5	5	0.02
	Zona 2						
5	Doberdol	60	47	78.7%	61	14	2.1
6	Gllarevë	314	186	59.2%	317	133	11.06
7	Ujmir	96	62	64.7%	97	35	3.37
	Zona 3						
8	Perqevë	177	102	57.6%	178	78	6.23
9	Qupevë	102	33	32.4%	103	71	3.59
	Zona 4						
10	Dugajevë	70	23	32.7%	71	48	2.47
11	Bokshiq	76	35	45.9%	77	42	2.69
12	Qeskovë	66	37	56.3%	67	30	2.31
13	Dollovë	78	55	70.4%	79	24	2.83
	Zona 5						
14	Jagodë	35	34	98%	35	1	1.22
15	Krushevë e Madhe	103	95	92.2%	105	10	3.63
16	Zllakuqan	116	114	98.1	118	4	4.09

Total	1578	918		1597	684	55.33
--------------	-------------	------------	--	-------------	------------	--------------

Në këtë fazë shërbimi do të zgjerohet 100% në 16 fshatra (shih tabelënmë sipër). Përqindja e rritjes së shërbimit krahasuar me numrin e parashikuar të rritjes së amvisërive (6,933 amvisëri) për vitin 2017 është 9.8% apo 684 amvisëri. Sasia e mbeturinave totale për grumbullim është 55.33 ton për javë.

5.3.1.2.3 Faza e tretë: viti 2019

Tabela Nr. 31: Faza e tretë e zgjerimit të shërbimeve në vitin 2019

	Vendbanimi	Nr. amvisërv e 2016	Amvisëri te sherbyer a 2016	Amvisëri të sherbye ra 2016 %	Vlerësimi i rritjes së amvisërv e 2019	Amvisëritë për t'u përfshi në shërbim 2019	Gjenerimi i mbeturinav e 2019 t/javë
Zona 1							
1	Ranoc	62	62	100%	64	2	2.25
2	Leskoc	42	42	100%	43	1	1.52
3	Binxhë	21	0	0%	21	21	0.75
4	Grabc	36	0	0%	37	37	1.31
5	Jashanicë	314	112	35.7%	322	210	11.37
6	Resnik	70	0	0.0%	72	72	2.54
Zona 2							
7	Rixhevë	153	65	42.4%	156	91	5.55
8	Zabergjë	128	82	64%	131	49	4.64
9	Cabiq	152	89	58.6%	155	66	5.49
10	Caravik	219	168	76.9%	224	56	7.91
11	Siqevë	236	63	26.7%	241	178	8.53
Zona 3							
12	Sferkë	431	237	55%	438	201	15.6
13	Volljak	164	99	60.5%	166	67	5.92
14	Dush i Vogël	35	28	81.1%	35	7	1.25
Zona 4							
15	Pjeterq i Poshtëm	28	45	100%	29	0	1.02
16	Pjetërqi i Epërm	99	43	43.4%	102	59	3.59
17	Kpuz	110	66	60.3%	111	45	3.96
Zona 5							
18	Nagllavë	12	2	17%	12	10	0.43
19	Bërkovë	43	25	57.7%	52	27	1.57
20	Budisalc	70	64	91.3%	72	8	2.54
21	Stupë	32	32	100%	32	0	1.14
22	Rudicë	79	55	70%	80	25	2.84
Total		2536	1379		2595	1232	91.72

Në këtë fazë shërbimi do të zgjerohet 100% në 22 fshatra (shih tabelënmë sipër). Përqindja e rritjes së shërbimit krahasuar me numrin e parashikuar të rritjes së amvisërive (6,988 amvisëri)

për vitin 2017 është 17.6% apo 1,232 amvisëri. Sasia e mbeturinave totale për grumbullim është 55.33 ton për javë.

Tabela Nr. 32: Rritja e mbulueshmërisë së shërbimit 2017 - 2019

Rritja e mbulueshmërisë së shërbimit	total	Rritja në % për vit
Mbulueshmëria aktuale 2016	60%	-
Rritja e mbulueshmërisë 2017	72.7%	12.7%
Rritja e mbulueshmërisë 2018	82.6%	9.9%
Rritja e mbulueshmërisë 2019	100%	17.4%

Komuna e Klinës do të mbërrijë mbulim me shërbime për të gjithë qytetarët e saj në fund të vitit 2019. Ky mbulim do të bëhet në mënyrë graduale duke aplikuar rritje prej 12.7% në vitin 2017, 9.9% në vitin 2018 dhe 17.4% në vitin 2019.

5.3.1.2.4 Planifikimi i kamionëve për faza të zgjerimit

Për arsye se kompania nuk ka mundësi të blejë makineri të re për shkak kostos së lartë një strategji tranzitore e zbatuar përgjatë periudhës planifikuese do të ishte që makineritë më të vjetra se dhjetë vite të largohen nga operimi ndërsa kompania të blejë makineri 3-5 vjetë të bartura por të cilat janë në gjendje të mirë operative.

Tabela Nr. 33: Klasifikimi i kamionëve të KRM Ambienti në varësi të moshës

	Lloji i mjetit transportues	Viti i prodhimit	Mosha në 2016
1.	Iveco Calabrese Kompaktues	2000	16
2.	Mercedes Kompaktues	1980	36
3.	Mitsubishi	2012	4

Nëse aplikohet ky princip atëherë kompania ka vetëm një kamionë në gjendje të rregulltë. Kapaciteti grumbullues i tijë vjetor është 2,028 ton dhe i njëjti është llogaritur veq e veq për secilin kamion i cili duhet të realizojë për dy udhëtime për ditë pesë herë në javë duke zbatuar kapacitetin grumbullues për udhëtim. Realizimi i dy udhëtimeve për ditë është në funksion të shfrytëzimit optimal të makinerive ndërsa planifikimi i shfrytëzimit pesë ditorë gjatë javës mundëson që kompania të ketë fleksibilitet në rastet e remonteve dhe defekteve të kamionëve.

Tabela Nr. 34: Kamionët e KRM Ambienti në gjendje optimale operative

	Kamioni	Viti i prodhimit	Kapaciteti	Kapaciteti grumbullues për udhëtim	Kapaciteti grumbullues Vjetor
	Mitsubishi	2012	4 ton	3.5 ton	1,800–2,000 ton
Total Kapaciteti				3.5 ton	1,800–2,000 ton

Duke pasur parasysh se zgjerimi i shërbimit nënkupton rritjen e sasisë së grumbullimit të mbeturinave kjo parashtrohet edhe sigurimin e kapaciteti grumbullues dhe transportues të mbeturinave me kamionë përkatës.

Tabela Nr. 35: Kalkulimi për nevojat e sigurimit të kamionëve

Lloji i mekanizimit	Viti i prodhimit	Kapaciteti ngarkues	Ngarkesa për kamion	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Iveco Calabrese	2000	7.0	6.0	16	17	18	19	20	21
Mercedes	1980	7.0	6.0	36	37	38	39	40	41
Mitsubishi	2012	4.0	3.5	4	5	6	7	8	9
Sasia e mbledhur e mbeturinave	-	-	-	7,079	8,745	10,142	12,593	13,105	13,474
Kapaciteti grumbullues	-	-	-	-	1,974	8,277	9,576	13,100	13,475
Investimi shtese ne kapacitet	-	-	-	-	6,768	1,869	3,024	-	-
Kamion Kompaktues	2012	7.0	6.0	-	5	6	7	8	9
Kamion Kompaktues	2012	7.0	6.0	-	5	6	7	8	9
Kamion Kompaktues	2013	4.0	3.5	-	-	5	6	7	8
Kamion Kompaktues	2014	7.0	6.0	-	-	-	5	6	7
Kamion Kompaktues	2015	4.0	3.5	-	-	-	-	5	6
Kamion Kompaktues	2016	4.0	3.5	-	-	-	-	-	5

Kalkulimet në bazë të treguesve të sipërpërmendur sugjerojnë blerjen e 6 kamionëve përgjatë periudhës planifikuese tren ga të cilët me kapacitet prej 7 tonësh dhe tre të tjerë me kapacitet prej katër tonësh. Pesë nga këta kamionë për periudhën 2017-2019 janë esencial për mirëmbajtjen e kapaciteteve operative ndërsa në rast të mungesës së fondeve kamionët katër tonësh në vitin 2020 dhe 2021 mundë të mos blihen meqë ata janë më shumë të orientuar në zëvendësimin e kamionëve më të vjetër.

5.3.1.3 O3: Përmirësimi i infrastrukturës për grumbullim të mbeturinave, duke siguruar kontejner për çdo familje, në mënyrë graduale, deri në plotësim të kërkesave 100%, në fund të vitit 2019.

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave do të vazhdojë të funksionojë me kontejnerat 120 lit., 1.1 m³, dhe 7m³, dhe me qese te plastikës. Mirëpo, plani do të rishikojë sistemin me të cilin vendbanimet do të shërbehën. Kjo nënkupton që vendbanimet/zonat do të shërbehën me një lloj të kontejnerëve, me disa lloje të kontejnerëve, apo edhe me qese varësisht nga rrugët, shpërndarja hapësinore dhe konfiguracioni i terrenit në të cilin gjenden vendbanimet. Sistemi i menaxhimit të mbeturinave është i ndërlidhur ngushtë me transfer stacionin e përbashkët me komunën e Istogut. Transfer stacioni do të shërbejë si pikë kyce për të rishikuar sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Klinë, dhe do të ndikojë në optimalizimin e shpenzimeve për shërbim.

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave është i lidhur ngushtë me objektivin e tretë i cili i përcakton fazat e rritjes së mbulimit me shërbim. Kështu që edhe sistemi i menaxhimit të mbeturinave do të rishikohet në tri faza duke filluar nga viti 2017, 2018 dhe 2019.

Tabela Nr. 36: Identifikimi i nevojës për kontejner

Faza 1 – viti 2017			Faza 2 – viti 2018		
	Vendbanimi	Kontejnerët		Vendbanimi	Kontejnerët
1	Klinafc	120 lit	1	Kërnice	120 lit
2	Pograxhë	120 lit	2	Shtupel	120 lit

3	Gjurgjevik i Vogël	120 lit	3	Dranashiq	120 lit
4	Drshnik	120 lit	4	Jelloc	120 lit
5	Dush	120 lit	5	Doberdol	120 lit
6	Gjurgjevik i Madh	120 lit	6	Gllarevë	120 lit
7	Dollc	120 lit	7	Ujmir	120 lit
8	Gremnik	120 lit	8	Perqevë	120 lit
9	Zajm	120 lit	9	Qupevë	120 lit
10	Drenoc	120 lit	10	Dugajevë	120 lit
11	Grabanicë	120 lit	11	Bokshiq	120 lit
12	Deiq	120 lit	12	Qeskovë	120 lit
13	Videjë	120 lit	13	Jagodë	120 lit
14	Krushevë e Vogël	120 lit	14	Krushevë e Madhe	120 lit
15	Raduloc	120 lit	15	Zllakuqan	120 lit
16	Klinë - qyteti	7m³; 1.1m³; 120 lit			
Total kontenjera		874	Total kontenjera		660
Faza 3 – viti 2019					
	Vendbanimi	Kontenjerët		Vendanimi	Kontenjerët
1	Ranoc	120 lit	12	Sferkë	120 lit
2	Leskoc	120 lit	13	Volljak	120 lit
3	Binxhë	120 lit	14	Dush i Vogël	120 lit
4	Grabc	120 lit	15	Pjeterq i Poshtëm	120 lit
5	Jashanicë	120 lit	16	Pjetërq i Epërm	120 lit
6	Resnik	120 lit	17	Kpuz	120 lit
7	Rixhevë	120 lit	18	Nagllavë	120 lit
8	Zabergjë	120 lit	19	Bërkovë	120 lit
9	Cabiq	120 lit	20	Budisalc	120 lit
10	Caravik	120 lit	21	Stupë	120 lit
11	Siqevë	120 lit	22	Rudicë	120 lit
Total kontenjera					1,232

Në vitin 2017 komuna duhet të buxhetojë mjete për blerjen e 900 kontenjerëve.
Në vitin 2018 komuna duhet të buxhetojë mjete për blerjen e 700 kontenjerëve, dhe në vitin 2019 komuna duhet të buxhetojë mjete për blerjen e 1,250 kontenjerëve.
Në rast që komuna nuk do të mund të buxhetojë për këtë numër të kontenjerëve, zgjerimi në faza nuk duhet të ndalojë. Zgjerimi mund të kryhet edhe me qese të plastikës, derisa komuna të buxhetojë mjete për kontenjera.

5.3.1.4 O4: Identifikimi i lokacionit për transfer stacion

Në mënyrë që sistemi i menaxhimit të mbeturinave të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme është e nevojshme të gjendet lokacioni i përshtatshëm për ndërtimin e transfer stacionit. Siç u cek më lartë PMM parasheh që në Klinë të ndërtohet transfer stacioni. Ky rekomandim nga PMM është i logjikshëm duke marrë parasysh largësinë e deponisë rajonale të Pejës në Sferkë, deponi kjo që është 20 km nga Klinë – udhëtim në shkuarje dhe ardhje 40 km.

PMM rekomandon që të ndërtohen edhe një transfer stacion edhe për komunën e Istogut. Duke marrë parasysh afërsinë gjeografike të këtyre dy komunave, dhe të dyja këtyre komunave me deponinë rajonale të Pejës në Sferkë, është më së e logjikshme që komuna e Klinës dhe Istogut të dakordohen për një transfer stacion të përbashkët. Ky veprim do t'i mundësonte nivelit

qendror, apo edhe të të dy komunave që të investojnë me lehtë në ndërtimin e këtij transfer stacioni.

5.3.2 Qëllimi 3: Inicimi i procesit për ndarje të mbeturinave në burim duke synuar që të zvogëlohet sasia e mbeturinave që përfundojnë në deponi

Ndarja e mbeturinave në burim dhe në institucione është hapi i parë drejt ndarjes së mbeturinave në burim në të gjitha amvisëritë, dhe rrjedhimisht zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që shkon në deponi.

Ky proces shihet si parakusht për të filluar ndarjen në burim në amvisëri sepse mundëson që fëmijët në shkollë të mësojnë për pikat pozitive të ndarjes së mbeturinave dhe si ti ndajnë ato. Supozohet që këtë njohuri dhe mesazh fëmijët të përcojnë në familjet e tyre duke i inkurajuar që të fillojnë me ndarjen e mbeturinave në burim. Procesi i ndarjes në burim në institucione publike supozohet që do të inkurajoj punonjësit e sektorit publik në mënyrë që të bartin këtë praktikë edhe në shtëpitë e tyre.

Ndarja në burim do të fillojë të aplikohet në shkolla dhe institucione publike sepse ndarja në këto institucione është me e lehtë dhe më pak e komplikuar në krahasim me ndarjen në burim në amvisëri. Në të njëjtën kohë ndarja dhe reciklimi i mbeturinave do të mundësojë arritjen e caceve të Strategjisë për Menaxhim të Mbeturinave 2015 – 2020 për të ulur sasinë e mbeturinave që shkojnë në deponi.

5.3.2.1 O5: Ndarja e mbeturinave në burim në shkollat publike dhe institucionet publike komunë e Klinës në mënyrë graduale deri në përfshirje 100% në fund të viti 2020.

Procesi i ndarjes së mbeturinave do të organizohet në tri faza. Ndarja e mbeturinave fillimisht do të bëhet në tri fraksione: (1) Letër, plastikë; (2) Qelq, kanaqe; dhe (3) të tjera.

Faza e parë e ndarjes së mbeturinave në burim do të fillojë në vitin 2018 me shkollat dhe institucionet publike që gjenden në qytetin e Klinës. Faza e parë e ndarjes në burim do të fillojë në institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme dhe në ndërtesën e administratës komunale.

Faza e dytë e ndarjes së mbeturinave në burim do të fillojë në vitin 2019 me institucionet tjera publike që gjenden në qytetin e Klinës. Faza e dytë e ndarjes në burim do të fillojë në institucionet si në vijim: Administrata për Pensione, Bridaga e Zjarrëfiksëve, Gjykata, Qendrat e Mjekësisë Familjare, Stacioni Policor, Qendra për Punë Sociale, Biblioteka, Teatri, Qendra rinore, Palestra sportive, Post dhe Telekom i Kosovës, KEDS, etj.


Faza e tretë e ndarjes së mbeturinave në burim do të fillojë në vitin 2020 me institucionet publike dhe shkollat që gjenden në zonat rurale të komunës së Klinës. Faza e tretë e ndarjes në burim do të fillojë në institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme, qendrat e mjekësisë familjare, dhe zyret e vendit.

Për ndarjen në burim nëpër institucione komuna do të zbatojë një hulumtim në terren në mënyrë që identifikon në saktësi numrin e nevojshëm të kontenjereve për institucion. Hulumtimi nënkupton vizitë në çdo objekt për të kuptuar planimetrinë dhe madhësinë e objekteve, dhe numrin e nxënësve dhe punonjësve. Ky hulumtim do t'i mundësojë komunës që të identifikojë më saktësi numrin e kontenjerave për ndarje si dhe llojin e tyre.

5.3.2.2 O6: Inicimi i ndarjës së mbeturinave në burim, në dy fraksione (të reciklueshme dhe të pa reciklueshme) në një lagje të komunës deri në fund të viti 2021.

Në mënyrë që ndarja e mbeturinave në burim të këtë sukses duhet të fillohet nga ato zona të qytetit apo vendbanimve në të cilat niveli i inkasimit është i kënaqshëm. Supozohet që ato zona të cilat paguajnë rregullisht tarifën e mbeturinave janë të gatshme edhe të bëjnë ndarjen e tyre.

Harta Nr. 11: Lokacioni i përzgjedhur për ndarjen e mbeturinave në burim



Hapësira e cila është përzgjedhur për të filluar me ndarjen e mbeturinave në burim gjendet në pjesën veri-lindore të qytetit, konkretisht rruga Ismail Qemajli – zona 1 (shih hartën më lartë). Shfrytëzimi i tokës në këtë zonë është kryesisht shtëpi individuale dhe shitore. Zona ka përafërsisht 170 – 200 njësi familjare – shtëpi individuale dhe shitore. Ndarja e mbeturinave në burim do të përfshijë shtëpitë individuale sepse për inicim të procesit të ndarjes së mbeturinave është më lehtë të fillohet me shtëpi individuale për shkak të qasjes së lehtë në këtë zonë. Inicimi i ndarjes së mbeturinave në këtë zonë do të trajtohet si pilot projekt nga i cili do të nxjerren mësimet dhe mandej të kalohet gradualisht në pjeset më të dendura të qytetit.

Amvisëritë në këtë zonë do të bëjnë ndarjen e mbeturinave në dy fraksione, në mbeturina të reciklueshme dhe në ato të pa reciklueshme. Në fraksionin e mbeturinave të reciklueshme hyn: letër, karton, plastike, PET, dhe kanaqe. Ndërsa në ato të pa reciklueshme hyn të gjitha mbeturinat tjera. Komuna do të ofrojë dy kontenjerë të plastikës për çdo amvisëri, njëri do të shërbejë për mbeturina të reciklueshme dhe tjetri për ato të pa reciklueshme.

Procesi i ndarjes së mbeturinave në burim në amvisëri konsiderohet hapi i fundit dhe më sfiduesi në rrjedhën e ndarjes së mbeturinave. Si i tillë ky proces do të zbatohet vetëm pasi që ndarja në burim ka përfunduar apo t'paktën ka filluar mirë në objektet publike dhe shkollat e komunës së Klinës.


Për ndarje në burim në shtëpi individuale në vitin 2019 komuna e Klinës do të buxhetojë për 400 kontenjerë të plastikës 120 lit.

5.3.2.3 O7: Prezentimi i ishujve të gjelbër, në qytetin e Klinës, për të mundësuar hedhjen e mbeturinave të ndara në disa fraksione, në 5 lokacione deri në fund të viti 2021.

Krahas ndarjes së mbeturinave në burim, komuna e Klinës do të instalojë edhe pika të grumbullimit për mbeturinave të ndara apo të reciklueshme, apo ishuj të gjelbër. Duke instaluar ishujt e gjelbër komuna synon që të ulë sasinë e mbeturinave që shkojnë në deponi, të mbrojnë ambientin dhe në të njëjtën kohë të krijojnë mundësi për bizneset lokale që të merren me mbeturinat e recikluara.

Në këto pika qytetarët do të mund të hedhin mbeturinat e ndara në këto fraksione: lëtar, plastikë, qelq, biodegraduese, tekstil dhe bateri nga pajisjet elektronike dhe elektrike. Qytetarët mund të hedhin mbeturinat e ndara në ishujt e gjelbër pa u aplikuar ndonjë tarifë.

Figura Nr. 3: Përmbajtja dhe dizajni i ishujve të gjelbër



Ishujt e gjelbër do të instalohen në tërë zonën e qytetit, konkretisht në 5 lokacione. Lokacionet në të cilat do të instalohen ishujt e gjelbër janë kryesisht hapësirat më të frekuentuara të qytetit dhe udhëkryqet e rrugëve. Është detyrë e drejtoratit për shërbime publike që në bashkëpunim me drejtoratin e urbanizmit të përcaktojë lokacionet në të cilat do të instalohen ishujt e gjelbër. Lokacionet e përzgjedhura duhet të jenë në pronë publike, duhet të kenë qasje të përshtatshme për kamion për zbrazjen e kontenjerëve, qasje të përshtatshme për këmbësorë të cilët i hedhin mbeturinat, dhe përfundimisht nuk duhet të ndërtohen brenda parkingjeve ku qasja e kamionëve për zbrazje është e pamundur.

Për këtë objektiv, komuna në vitin 2017 do të buxhetojë mjete për blerjen e 25 kontenjerëve të plastikës 1.1m³, 5 kontenjerë të plastikës 120 lit dhe rregullimin e hapësirave për vendosjen ishujve të gjelbër.

5.3.2.4 O8: Ndërtimi i oborrit të riciklimit, në komunë, për të mundësuar hedhjen e mbeturinave të vëllimshme dhe mbeturinave të vecanta.

Instalimi i qendrës për grumbullim të mbeturinave të vëllimshme dhe të vecanta do të eliminojë problemin e bartjes së këtij lloji të mbeturinave së bashku me mbeturinat komunale të përditshme që krijon problem në transport si dhe në krijimin e deponive ilegale. Për më tepër qendra do të ndihmojë që të reduktohet sasia e mbeturinave që shkojnë në deponi, dhe do të krijojnë mundësi të mirë për ndarje dhe reciklim të këtyre mbeturinave.

Komuna e Klinës do të instalojë qendrën për grumbullim dhe ndarjen e mbeturinave të vëllimshme. Kjo qendër do të ndërtohet sëbashku me transfer stacionin, apo alternativisht si qendër e ndarë. Qytetarët e komunës së Klinës do të mund që të deponojnë mbeturinat e

vëllimshme dhe të vecanta në këtë qendër pa pagesë. Në këtë qendër do të mund të deponohen këto lloje të mbeturinave:

- Mbeturinat nga pajisjet e mëdha shtëpiake: mobilje, frigorifer, rrobalarës, stufat elektrike etj,
- Pajisjet e vogla shtëpiake: televizorë, kompjuterë, thithëse të pluhurit, tosterët, pajisje për pastrim të tepihëve, pajisje për qepje, etj,
- Mbeturinat e letrës, plastikës, qelq dhe mbetura biodegraduese.
- Mbeturinat e vecanta: tekstil, bateri të automjeteve, bateri nga pajisjet elektronike dhe elektrike, goma, mbetje të drurit, vaj gatimi, vajra të automjeteve, qelq, mbetje të gjelbërta nga kopshtet.

Operatori që është kontraktuar për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave do të bejë mbledhjen e mbeturinave të vëllimshme cdo dy muaj nga amvisëritë, bizneset dhe institucionet. Ky shërbim do të kryhet pa pagesë nga operatori që e bënë grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në komunë.

Për këtë objektiv, komuna në vitin 2017 do të buxhetojë mjete për të zhvilluar një hulumtim që do të saktësojë në detale numrin dhe llojin e kontenjerëve, dhe mjeteve tjera përcjellëse për të funksionalizuar një qendër të tillë për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme dhe atyre të vecanta.

5.3.2.5 O9: Krijimi i sistemit lokal të kompostimit, përmes sigurimit të komposterëve individual për 700 familje deri në fund të viti 2021

Një ndër synimet e komunës së Klinës është që të ulë sasinë e mbeturinave biodegradues/organike që shkojnë në deponi. Komuna do të instalojë sistem lokal të kompostimit nëpërmes së cilit do të inkurajojë qytetarët e saj të ndajnë dhe kompostojnë mbeturinat biodegraduese/organike.

Kompostimi është trajtim i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit – plehut nën kuste të kontrolluara. Mbeturinat e biodegradueshme janë mbeturinat nga kopshtet, parqet, ushqimet nga mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, shitoret me pakice dhe nga impiantet për përpunim të ushqimit.

Sic u tha më lartë kompostimi e ul sasisë e mbeturinave që shkojnë në deponi sepse me anë të këtij procesi në mund të kompostojmë mbeturinat organike, mbeturinat e gjelbërta të kopshtit dhe mbeturinat nga letra të cilat përbejnë më shumë se 60% të mbeturinave.


Për këtë arsye komuna do të ofrojë kontenjerat të vecantë pa pagesë për kompostim për ato amvisëri të cilat shprehin gatishmërinë që të fillojnë me kompostim. Qytetarët të cilët janë të rregullt në pagesën e tarifës për mbeturina komuna e Klinës do t'ju ndajë kontenjerat si shpërblim për konsumatorë. Rëndësi të vecantë do t'i kushtohet zonës (nga objektivi 5) në të cilën do të fillohet me ndarje në burim dhe fshatrave që merrem më shumë me prodhime bujqësore.

Për më shumë komuna do të shtojë përpjekjet e saja që të fut në sistem lokal të kompostimit edhe restorantet dhe impiantet për përpunim të ushqimit. Për këtë arsye komuna do të ofrojë kontenjerat për kompostim edhe për këto biznese.

Kompostimi është sfidë e vecantë duke marrë parasysh problemet me të cilat përballemi dhe shkallën e zhvillimit ekonomik. Sistemi i centralizuar i kompostimit nuk do të ishte zgjidhje për

shkak të shpenzimeve të mëdha financiare që do të nevojiteshin për t'i kriju këto qendra. Për këtë arsye komuna do të iniciojë krijimin e një sistemi lokal, i cili, varësisht nga performanca do të mund të ngritet në nivel më të lartë.

Figura Nr. 4: Ena kompostuese



5.3.3 Qëllimi 3: Grumbullimi, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të vecanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi.

5.3.3.1 O10: Grumbullimi dhe transportimi i vecantë i mbeturinave shtazore deri në vitin 2017. Mbeturinat shtazore janë mbeturinat e mishit, eshtrave dhe lëkurës që krijohen nga therrëtorët, mishtoret dhe impiantet për përpunim të mishit. Mbeturinat shtazore janë pjesë e mbeturinave të vecanta për të cilat është përgjegjëse komuna. Praktika e deritashme e grumbullimit të përzier të mbeturinave komunale së bashku me ato shtazore nuk është e qëndrueshme. Kjo për shkak të ndikimit negativ në mjedis pasi që këto mbeturina të janë të përziera , dhe për shkak të implikimeve financiare gjatë deponimit të tyre në deponinë regjionale apo transfer stacion.

Meqenëse, në Kosovë nuk ekziston impiant i vecantë për trjatin e mbeturinave shtazore, dhe derisa një zgjidhje e tillë të ofrohet nga niveli qendror komuna e Klinës është zotuar të përmirësojë sistemin e grumbullimit të mbeturinave shtazore.

Komuna do të angazhojë operatorë të vecantë apo do të mundësojë makineri të vecantë për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave shtazore. Në të njëjtën kohë komuna në bashkëpunim me bizneset do të sigurojë kontenjerë të vecantë mishtoreve, therrëtove, fabrikave për përpunim të mishit, dhe fermave, në të cilat do të deponohen mbeturinat shtazore. Kontenjerët e vecantë për mbeturina shtazore duhet të jenë rezistent ndaj korrozionit dhe të pa-përshkueshëm nga mbeturinat e lëngëta që lirohen nga këto mbeturina, në të njëjtën kohë kontenjerët duhet të jenë të pajisur me kapak mbyllës hermetik për mos kundërmim.

Figura Nr. 5: Kontejnerët për mbeturina shtazore



Për këtë objektiv, komuna nëpërmes rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave do të kërkoj nga mishtorët, therrëtorët, dhe fermat që në afat deri në Maj të vitit 2017 të pajisen me kontejnerë të vecantë për mbeturina shtazore. Zbatimi i kësaj dispozite të rregullores do të bëhet nëpërmes inspektorëve mjedisor të komunës së Klinës. Inspektorët e mjedisit do të kenë përkrahjen e zyrë së kryetarit në mënyrë që të kenë sukses në zbatimin e saj.

5.3.3.2 O11: Krijimi i infrastrukturës së vecantë për mbeturina medicinale deri në fund të vitit 2017

Edhe pse mbeturinat medicinale janë përgjegjësi e nivelit qendror, një pjesë e madhe e tyre përfundon në kontejnerat e përbashkët, të dezinfektuara dhe të pa dezinfektuara. Këto mbeturina krijojnë probleme sepse i kontaminojnë mbeturinat në kontejnerë komunal, mund të shkaktojnë epidemi për sektorin joformal që grumbullon mbeturina nga kontejnerët, dhe në fund krijon probleme serioze për transportim dhe deponimin e tyre.

Komuna, respektivisht drejtoria për shëndetësi, në bashkëpunim me Spitalin Rajonal do të vendos kontejnera të vecantë në të cilat do të hedhen mbeturinat medicinale. Spitali Rajonal do të instaloj kontejnerë për dy fraksione të mbeturinave, njëri do të shërbejë për të hedhur mbeturina të dezinfektuara dhe tjetri për të hedhur mbeturina të padezinfektuara. Parimisht, mbeturinat medicinale do të duhej të të asgjësoheshin apo të dezinfektoheshin, mirepo, kjo nuk ndodh rregullisht, kështu që komuna i vuan pasojat. Për këtë arsye, komuna duhet që nëpërmes inspektorëve të saj të rregulloj këtë ceshtje shumë të ndjeshme.



5.3.3.3 O12: Lokacioni për ndërtimin e qendrës për trajtimin e mbeturinave ndërtimore është definuar.

Mbeturinat ndërtimore janë lenda apo objekti i destinuar për braktisje të cilat krijohen gjatë ndërtimit, rindërtimit, renovimit, apo shkatërrimit të objekteve ndërtimore. Mbeturinat nga ndërtimi dhe shkatërrimi i objekteve ndërtimore përfshijnë materialet si: gurë natyror, gurë të latuar, blloka, beton, drurë, plastik, qelq, mbeturinat e metalit etj.

Bartja e mbeturinave nga ndërtimi bëhet nga persona të licensuar dhe nga prodhuesi i mbeturinave. Në mënyrë që mbeturinat nga ndërtimi të trajtohen në mënyrë të qëndrueshme rekomandohet që komuna të angazhojë persona të licencuar që do të bëjnë bartjen e mbeturinave nga prodhuesit e mbeturinave.

Ky veprim është i domosdoshmë duke marrë parasysh se qytetarët po i hedhin mbeturinat në hapësira publike duke shkaktuar probleme mjedisore. Për më shumë komuna do t'i ofrojë kontratë bashkepunimi operatorit të licensuar për bartjen e mbeturinave nga ndërtimi për të trajtuar këto mbeturina. Ky veprim konsiderohet si incentivë për operatorët e licensuar për të trajtuar këto mbeturina më makineritë e tyre.

5.3.4 Qëllimi 4: Eliminimi i deponive ilegale në komunë, sanimi dhe parandalimi i rikrijimit të tyre, me qëllim të ruajtjes së ambientit dhe parandalimit të emergjencave mjedisore

5.3.4.1 O13: Eliminimi i deponive ilegale gjatë përgjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019 dhe parandalimi i krijimit të tyre në vazhdimësi.

Komuna e Klinës duhet të sigurojë buxhet për të eliminuar deponitë ilegale përgjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019 për atë kohë sa do të shtrihet mbulimi i plotë me shërbim për të gjithë banorët, institucionet dhe bizneset. Në të njëjtën kohë, komuna do të merr masa për të parandaluar krijimin e deponive ilegale të reja nëpërmes inspektorëve të saj mjedisor.

Për këtë objektiv, komuna do të sigurojë vizita për çdo javë në terren nëpërmes inspektorëve të saj mjedisor për të monitoruar dhe parandaluar hudhjen ilegale të mbeturinave. Vizitat në terren duhet të korrespondojnë me shtrirjen e planifikuar të shërbimit sipas objektivit 2. Në të njëjtën kohë komuna do të vendosë tabelë informimi për çdo deponi ilegale të pastruar, e cila tabelë do të informojë qytetarët për masat ndëshkuese për qytetarët të cilët hedhin mbeturinat në mënyrë ilegale.

5.3.5 Qëllimi 5: Konsolidimi i strukturës brenda komunës për menaxhim të mbeturinave si dhe vendosja dhe zhvillimi i procesit të planifikimit dhe implementimit të PKMM.

5.3.5.1 O14: Reformat administrative

5.3.5.1.1 O14.1 Themelimi i njesisë për menaxhimin e mbeturinave

Komuna do të instalojë njësinë për menaxhim të mbeturinave brenda drejtoratit për shërbime publike. Njësia do të përmbajë të paktën një staf që do të ketë përgjegjësinë për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave. Njësia për menaxhim të mbeturinave do të jetë përgjegjëse për zbatimin e PKMM-së, dhe çdo staf i sajë do të ketë të hartuara detyrat dhe përgjegjësitë për vendin e tyre të punës. Në rastin më të mirë, komuna do të vendosë njësinë me udhëheqësin e saj dhe dy punëtorë.

5.3.5.1.2 O14.2 Miratimi i rregullës për menaxhim të mbeturinave

Komuna, respektivisht drejtoria për shërbime publike do të hartojë dhe miratojë rregulloren për menaxhim të mbeturinave menjëherë pas miratimit të planit komunal për menaxhim të mbeturinave.

Analiza e rrjedhes së parave në kompani nga të hyrat e tarifës dhe nga të hyrat e shërbimeve tjera, dhe përcaktimi i caceve për të arritur shkallën e dëshiruar të inkasimit.
(Vërejtje: Analiza më e detajuar do të paraqitet në kapitullin financiar)

5.3.6.1 O16: Krijimi i kampanjës për vetëdijësim dhe informim rreth efekteve pozitive dhe negative të mbeturinave, rreth orarit dhe rregullave të grumbullimit dhe hedhjes së mbeturinave.

Kampanja e informimit dhe vetëdijësimit është e lidhur ngushtë me objektivat e mësipërme. Komuna do të përdorë kampanjën si mjet për të informuar qytetarët për reformat në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe për vetëdijësim.

Komuna do të organizojë të paktën 4 diskutime në vit rreth menaxhimit të mbeturinave në TV-të lokale. Komuna do të informojë qytetarët e sajë për masat e marra për eliminim të deponive ilegale dhe masave ndëshkuese.

6 Plani Financiar

Plani financiar përmban projeksionin e kostove dhe të hyrave për periudhën pesëvjeqare në funksion të realizimit të objektivave të përmbajtura në PKMM. Në vijm janë të dhëna projeksionet e kostove dhe të hyrave për periudhën 2016-2021.

6.1 Projekcioni i kostove të shërbimit

Projeksioni i kostove është reflektiv në zgjerimin e nivelit të shërbimit, rritjes së mbeturinave të cilat do të gjenerohen dhe grumbullohen, fuljes së shërbimeve të reja, investime të reja e kështu me radhë.

Tabela Nr. 37: Parametrat relevant operativ

	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Nr i popullsisë	40,061	40,381	40,704	41,030	41,35	41,689
Nr i amviserive	6,815	6,878	6,933	6,988	7,044	7,100
Nr i banorëve të shërbyer	24,184	29,285	33,301	40,537	41,35	41,689
Nr i amviserive të shërbyera	4,114	4,988	5,672	6,904	7,044	7,100
Shkalla e mbulimit me shërbim	60%	73%	82%	99%	100%	100%
Sasia e gjeneruar e mbeturinave për	0.80	0.82	0.83	0.85	0.87	0.89
Sasia e gjeneruar e mbeturinave	11,727	12,058	12,397	12,746	13,10	13,474
Sasia e mbledhur e mbeturinave	7,079	8,745	10,142	12,593	13,10	13,474
Nr i kamionëve në operim	3	3	4	5	5	5
Nr mesatar i ditëve të angazhimit për	-	282.0	267.0	252.0	262.0	269.5
Nr vjetor i udhëtimeve për gjithë	442	1,692	2,136	2,520	2,620	2,695
Mesatarja e mbeturinave për një drejtim		5.2	4.7	5.0	5.0	5.0
Mesatarja e kilometrave për një drejtim	64	50	50	50	50	50
Total kilometra	79,017	84,600	106,80	126,00	131,0	134,75
Nr i mbikqyrësve	1	1	1	1	1	1
Nr i vozitësve	3	3	4	5	5	5
Nr puntorëve	6	6	8	10	10	10

Kosto e përlogaritura përfshijnë koston e plotë të menaxhimit të mbeturinave përfshi kostot operative dhe kostot investive. Poashtu kostot përfshijnë kostot e ofrimit të shërbimit të mbeturinave dhe kostove tjera të cilat barten apo nga Komuna.

Premisat në të cilat janë zhvilluar kostot e MM përfshijnë:

- Zgjerimi i shërbimit në periudhën planifikuese do të bëhet nga ofruesi aktual i shërbimeve
- Dy udhëtime me kamionë do të realizohen brenda një turni
- Ngrirja e regrutimit të stafit shtesë administrativ përgjatë periudhës planifikuese
- TS në Istog do të ndërtohet ku mbeturinat do të deponohen dhe taksa e deponimit do të paguhet

6.1.1 Kostot direkte dhe administrative

6.1.1.1 Kostot direkte

Kostot direkte përfshijnë kostot direkte të grumbullimit, transferit dhe deponimit të mbeturinave si dhe kostot e pastrimit të rrugëve dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike. Kostot direkte përbëhen nga kostot e stafit direkt (pagat dhe sigurimet), kostot e materialit harxhues si nafta, vaji dhe gomat si dhe taksa e deponimit të mbeturinave meqë KRM Ambienti NjO Klinë do të deponoj mbeturinat tek TS dhe duhet ta paguaj taksën e deponimit.

Si bazë e kostove është marrë viti 2015 duke i bërë projeksionet e duhura përgjatë viteve. Kostoja e stafit është reflektive në numrin e kamionëve aktiv që bëjnë grumbullimin e mbeturinave, d.m.th. çdo kamionit aktiv i shoqërohet nga një vozitës dhe dy ndihmës si dhe një mbikëqyrës për tërë stafin direkt të grumbullimit të mbeturinave.

6.1.1.2 Kosto e materialit harxhues

Kosto e materialit harxhues është në funksion të rrugës së përshkuar për grumbullimin dhe transferin e mbeturinave. Gjatësia mesatare e udhëtimit është shkurtua nga viti 2015 për faktin se udhëtimet me skemën e re do të shkurtohen dhe do të jenë më efikiente. Plani parasheh reduktimin e kostove të mirëmbajtjes së kamionëve për faktin se kamionët më të rinj të siguruar nga programi investiv nuk do të duhej të shkaktonin defekte të shpeshta dhe rrjedhimisht do të ulin sigurimin e pjesëve rezervë të kushtueshme.

6.1.1.3 Kostot e deponimit

Projeksionet e kostove të deponimit janë bërë duke u bazuar në sasi të grumbulluara të mbeturinave dhe duke e zbatuar taksën aktuale të deponimit prej gjashtë euro për ton.

6.1.1.4 Pastrimi i rrugëve

Kosto direkte e pastrimit të rrugëve dhe veprimtarive tjera operative janë të paraqitura veqmas për koston e stafit direkt dhe kostot e materialit harxhues. Projeksionet e kostove për kategori nuk parashohin ngritje meqë në këtë sferë KRM Ambienti NjO Klinë mundet të ballafaqohet me konkurrencën e sektorit privat që imponon mbajtjen e qmimeve konkurruese në nivel tregu.

Tabela Nr. 38: Kostot direkte të MM

	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Kosto Direkte	114,752	148,279	180,212	217,030	222,493	226,498
Pagat direkte	46,950	46,950	57,690	68,430	68,430	68,430
Pagat – Mbledhja e mbeturinave	37,080	37,080	47,820	58,560	58,560	58,560
Pagat - Pastrimi i rrugëve	9,870	9,870	9,870	9,870	9,870	9,870
Kostot tjera direkte	67,802	101,329	122,522	148,600	154,063	158,068
Material Harxhues	39,594	42,262	52,869	62,043	64,433	66,224
Material Harxhues - Mbledhja e mbeturinave	37,756	40,424	51,031	60,205	62,595	64,386
Material Harxhues - pastrimi i rrugëve	1,838	1,838	1,838	1,838	1,838	1,838
Tatimi dhe sigurimet e makinerive direkte	11,930	6,600	8,800	11,000	11,000	11,000
Tatimet, Sigurimi Mirëmbajtja.	1,730	1,500	2,000	2,500	2,500	2,500
Mirëmbajtja e rregullt	6,100	3,600	4,800	6,000	6,000	6,000
Mirëmbajtja ne përgjithësi	4,100	1,500	2,000	2,500	2,500	2,500
Taksa e deponimit të mbeturinave	16,278	52,468	60,853	75,557	78,630	80,844

6.1.1.5 Kostot indirekte dhe administrative

Kostot indirekte dhe administrative përfshijnë pagat indirekte të KRM Ambienti, shpenzimet administrative si dhe kostot e fushatave vetëdijësuese të cilat do i organizoj komuna. Duke pasur për bazë se KRM Ambienti NjO Klinë ka të angazhuar një staf të konsiderueshëm administrativ, për rrjedhojë plani nuk parasheh ngritje të mëtejme të kostove administrative përgjatë periudhës planifikues si në regrutimin e stafit të ri ashtu edhe në shpenzimet përcjellëse.

Sa i përket fushatave vetëdijësuese ato do të fillojnë nga viti 2017 dhe do të jenë kontinuele. Ato do të përfshijnë transmetime të mesazheve audivizuele me transmetuesit lokal, shtypjen e fletushkave si dhe takimet me qytetarët duke përfshi këtu edhe nxënësit.

Përmes këtyre fushatave qytetarëve do iu jepen informata relevante mbi menaxhimin e mbeturinave, formave të avancuara të menaxhimit të mbeturinave si reduktimi, ndarja në burim, ripërdorim, riciklimi, mbeturinat shatzore, mbeturinat e vëllimshme, mbeturinat inerte e kështu me radhë. Qytetarët do të njihen me informata relevante si orari i shërbimit dhe mënyra e shërbimit, ofrimi i shërbimeve tjera si hudhja e mbeturinave të vëllimshme dhe inerte, ndarja e mbeturinave, ishujt e gjelbër dhe të ngjashme.

Tabela Nr. 39: Shpenzimet indirekte dhe administrative

	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Total shpenzimet administrative	55,844	60,844	60,844	60,844	60,844	60,844
Nga KRM Ambienti Njësia Klinë	55,844	55,844	55,844	55,844	55,844	55,844
Pagat e administratës	54,360	54,360	54,360	54,360	54,360	54,360
Shpenzimet tjera administrative	1,484	1,484	1,484	1,484	1,484	1,484
Nga Komuna	0.0	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
Kampanja vetëdijësuese	0.0	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000

6.1.1.6 Projeksionet e kostove kapitale

Kostot investive përfshijnë kostot kapitale për:

- sigurimin e kamionëve për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave,
- sigurimin e kontejnerëve publik dhe individual për grumbullimin e mbeturinave,
- sigurimin e kontejnerëve dhe infrastrukturës përcjellëse për ndarje dhe riciklim
- sigurimin e enëve kompostuese, dhe
- investimet në deponinë e materialit inert

6.1.1.7 Kostot investive për kamionë

KRM Ambienti NjO Klinë posedon 3 kamionë por dy nga ata janë më të vjetër se 10 vite dhe duhen të zëvendësohen. Planin investiv është bazuar në nevojat e përlogaritura në planin operativ për kamionë shtesë. Këta kamionë do të jenë me kapacitet prej 4 dhe 7 tonëve dhe të përdorur 3-5 vite (për shkak të kostos) por në gjendje të rregullt teknike.

6.1.1.8 Kostot investive për kontejnerë

KRM Ambienti NjO Klinë posedon një kontigjent të kontejnerëve 1.1 m3 por që të gjithë e kanë tejkaluar jetën e tyre ekonomike gjë që kërkon zëvendësimin e tyre me kontejnerë të rinj.

Poashtu zgjerimi i shërbimeve nënkupton sigurimin e kontejnerëve të plastikës 120 litra dhe sasia e tyre është bazuar në planin e zgjerimit sipas fazave.

6.1.1.9 Kostot investive për riciklim dhe ndarje

Në këto kosto përfshihen kostot e investimit në projektin e ishujve të gjelbër, koston e sigurimit të kontejnerëve plastik me ngjyrë 120 lit për ndarjen e mbeturinave në burim sipas llojit, si dhe ndërtimin e deponise komunale për mbeturina inerte dhe të vëllimshme. Në tabelën në vijim janë ofruar të dhëna të detajuara mbi investimet kapitale përgjatë periudhës 2017-2021.

Tabela Nr. 40: Lista e project propozimeve kapitale

Investimet në vitin 2017						
Tipi i investimit	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Arsyetim shtesë	Ndërlidhja e investimit me objektivat	
Kamion kompaktues me kapacitet ngarkues 7 ton për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave	2	30,000 €	60,000 €	KRM Ambienti në Klinë operon me 3 kamionë, 2 nga të cilët janë në gjendje të keqe. Përmes sigurimit të kityre kamionëve KRM Ambienti do të siguroj kapacitetin operativ, ngris cilësinë e shërbimeve dhe do reduktoj kostot e operimit dhe mirëmbajtjes.	O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime për të gjitha amvisëritë, institucionet dhe bizneset në komunën e Klinës, duke e arritë mbulueshmërinë e plotë deri në fund të vitit 2019.	
Kontejnerë 1.1 m3	50	320	16,000	Kontejnerët 1.1 m3 shërbejnë për ofrimin e shërbimit të mbeturinave për banesa kolektive, institucione, dhe dyqante në zonën urbane. Jetëgjatësia e këtyre kontejnerëve është 3 vjet dhë që të gjithë kontejnerët e KRM Ambienti janë më të vjetër dhe të tejamortizuar	O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime për të gjitha amvisëritë, institucionet dhe bizneset në komunën e Klinës, duke e arritë mbulueshmërinë e plotë deri në fund të vitit 2019.	
Kontenjera të plastikës 120 lit.	900	20 €	18,000 €	KRM Ambienti është përcaktuar për modelin e grumbullimit derë më derë për konsumatorët e amvisërive dhe bizneseve pa kontrat për zonën periurbane dhe zonat rurale. Sigurimi i këtyre kontejnerëve është drejtpërdrejt në funksion të futjes së konsumatorëve të ri në sistem.	O3: Përmirësimi i infrastrukturës për grumbullim të mbeturinave, duke siguruar kontejner për çdo familje, në mënyrë gradulae, deri në plotësim të kërkesave 100%, në fund të vitit 2019	
Rregullimi i hapësirës – bazamentit dhe rrethojave për vendosjen e ishujve të gjelbër	5	500 €	2,500 €	Ndarja e mbeturinave në burim është një praktikë e mirë e cila mundëson ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave në burim ku operatori mmundë të grumbulloj mbeturinat e caktuara të cilat do ti procesoj si dhe sasia e zvogëluar e mbeturinave që do të depozitohet në deponi do të ulë kostot e deponimit si dhe do të ulë impaktin negativ mjedisor nga mbingarkimi me mbeturina të deponive	O7: Prezentimi i ishujve të gjelbërt, në qytetin e Klinës, për të mundësuar hedhjen e mbeturinave të ndara në disa fraksione, në 5 lokacione deri në fund të viti 2021.	

Kontenjeri të plastikës 1.1 m³ - kontenjerë me ngyrë të cilët do të vendosën në ishujt e gjelbër	30	320 €	9,600 €	Ndarja e mbeturinave në burim është një praktikë e mirë e cila mundëson ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave në burim ku operatori mmundë të grumbulloj mbeturinat e caktuara të cilat do ti procesoj si dhe sasia e zvogëluar e mbeturinave që do të depozitohet në deponi do të ulë kostot e deponimit si dhe do të ulë impaktin mjedisor nga mbingarkimi me mbeturina të deponive	O7: Prezentimi i ishujve të gjelbërt, në qytetin e Klinës, për të mundësuar hedhjen e mbeturinave të ndara në disa fraksione, në 5 lokacione deri në fund të viti 2021.
Kontenjeri të plastikës 240 lit - kontenjerë me ngyrë të cilët do të vendosën në ishujt e gjelbër	10	30 €	300 €	Ndarja e mbeturinave në burim është një praktikë e mirë e cila mundëson ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave në burim ku operatori mmundë të grumbulloj mbeturinat e caktuara të cilat do ti procesoj si dhe sasia e zvogëluar e mbeturinave që do të depozitohet në deponi do të ulë kostot e deponimit si dhe do të ulë impaktin mjedisor nga mbingarkimi me mbeturina të deponive	O7: Prezentimi i ishujve të gjelbërt, në qytetin e Klinës, për të mundësuar hedhjen e mbeturinave të ndara në disa fraksione, në 5 lokacione deri në fund të viti 2021.
